



Krimet e luftës  
të viteve

90

në vendimet e  
gjyqësorit malazez

---

doracak për mësimdhënie

Podgoricë, 2024.

**Krimet e luftës të viteve 90 në vendimet e gjyqësorit malazez**  
-doracak për mësimdhënie -

**Botuesi:**  
Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ)

**Autorët:**  
Igor Radulović  
Milosh Vukanović

**Recezentë:**  
doc. dr Adnan Prekić

**Redaktorët:**  
Daliborka Ularević  
Damir Sulević

**Përktheu në gjuhën shqipe:**  
Monika Mrnjaçević

**Përktheu në gjuhën shqipe:**  
Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ)

**Qarkullimi:**  
100 copë

Ky publikim është pjesë e projektit "Edukimi për të Ardhmen - Drejtësia Tranzicionale për Pajtim" të Qendrës për Arsimim Qytetar (QAQ), në kuadër të projektit rajonal Mbështetja e BE-së për ndërtimin e besimit në Ballkanin Perëndimor, financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD).

Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetme e QAQ-së dhe e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e BE-së ose të PNUD-it.

# Krimet e luftës të viteve

# 90

## në vendimet e gjyqësorit malazez

doracak për mësimdhënie

Podgoricë, 2024.

# Përmbajtja

Parathënie	5
Konteksti juridik ndërkombëtar	8
Mali i Zi dhe luftërat e viteve 1990 – konteksti historik	11
Luftërat e vitit 1990 në sistemin arsimor malazez	16
Krimet e luftës të viteve 1990 në vendimet e gjyqësorit malazez - shembuj praktik për mësuesit	18
Rasti kampi Morinj	21
Rasti Deportimi	25
Krimet në Bukovicë	29
Vrasja e familjes Klapuh	33
Krimi në Shëtrpci	36
Rasti Kallugjerski laz	41
Rasti Zmajeviq	44
Rekomandime për mësuesit/et	48
Rishikimi	52

# Parathënie

Në shtet që rifitoi pavarësinë diçka më pak se dy dekada më parë, parimet demokratike, zhvillimi i identitetit dhe eliminimi i paragjyqimeve duhet të jenë norma që kultivohen dhe jo të lihen mënjanë. Fatkeqësisht, duket se këto vlera po neglizhohen, sepse *Historia* si lëndë mësimore po humb rëndësinë e saj.

Prandaj është e rëndësishme të theksohet se në procesin e pajtimit në të gjitha shoqëritë pas konfliktit (përfshirë edhe shoqërinë malazeze), historia duhet të luajë rolin vital. Shkenca dhe praktika kanë treguar se në shoqëritë që nuk përballen siç duhet me të kaluarën e tyre, mundësia e ripërtëritjes së konflikteve rritet në mënyrë dramatike. Rrjedhimisht, në epokën moderne që jetojmë, “ballafaqimi” me tema të caktuara bëhet një domosdoshmëri.

Në Mal të Zi ka shumë tema historike që duhen diskutuar dhe për të ngritur nivelin e ndërgjegjësimit të shoqërisë, por një nga më akutet janë ngjarjet në këto hapësira gjatë viteve të 90-ta të shekullit të kaluar. Por, për të diskutuar për këtë dhe tema të ngjashme, i domosdoshëm është reformimi i sistemit arsimor, por jo siç është bërë vitet apo dekadat e fundit, ku *Historia* vendoset në radhët e lëndëve arsimore të klasit të dytë. Në fakt, nevojitet pikërisht zbatimi i saj me gjithëpërfshirës dhe përfaqësimi në sistemin arsimor.

Për ta bërë më të qartë tablonë, duhet kujtuar se në sistemin e arsimit fillor, i cili është i detyrueshëm në Mal të Zi, historia mësohet në klasën e IX të shkollës fillore me vetëm një orë mësimi në javë dhe sipas planit mësimor, shpërbërja e Jugosllavisë dhe luftërat në ato hapësira mësohen në atë kohë. Kështu, gjatë vitit shkollor, përafërsisht 30 orë, mësuesit/et e *Historisë* duhet të shpjegojnë historinë e shekullit XX, të vlerësojnë nxënësit/et, të zhvillojnë kompetencat e tyre dhe të diskutojnë për vitet ‘90 të shekullit të kaluar. Në praktikë kjo gjë është e pamundur. Kjo minimizon rëndësinë e historisë si shkencë, lëndë mësimore dhe roli i saj reduktohet në rrjedhën e përshpejtuar të ngjarjeve që kanë formuar shoqërinë tonë sot. Situata në shkollat e mesme është pak më e mirë, sepse nxënësit/et kanë ende dy orë mësimi në javë. Nga ana tjetër, situata në shkollat profesionale është jashtëzakonisht e keqe, sepse *Historia* si lëndë pothuajse nuk ekziston, me justifikime jo bindëse, si “nxënësit/et e shkollave profesionale nuk kanë nevojë të dinë historinë, sepse nuk do të ju nevojitet në jetë”. Sipas kësaj logjike realiteti historik nuk na prek të gjithëve dhe kjo qasje selektive mund të ketë pasoja negative të pamatshme.

Ballafaqimi me të kaluarën e afërt, dhe luftërat në territorin e ish-Jugosllavisë gjatë viteve të 90-ta, është imperativ dhe kërkon një qasje të kujdesshme dhe të matur. Është detyra e çdo mësuesit/es të *Historisë* të merret me tema që shpesh konsiderohen kontroverse, sepse kjo do të kontribuojë në thyerjen e paragjyqimeve dhe stereotipeve tek të rinjtë, si dhe në prezantimin e parimeve

demokratike që janë të nevojshme. Nëse kjo temë nuk flitet sa duhet dhe nëse në një farë mënyre neglizhohet, gjeneratave të reja u shkakton dëm duke neglizhuar nevojat e tyre për të mësuar më shumë për gjërat që ende formojnë shoqërinë në të cilën jetojnë. Nevoja e supozuar për të “mbrojtur” brezat e ardhshëm nga tema që “nuk janë për ta” thëllon injorancën e tyre për rëndësinë e historisë, por edhe për zbatimin praktik të saj në zgjidhjen e konflikteve të caktuara.

Të rinjtë sot përballen shpesh me sfida, veçanërisht kur bëhet fjalë për marrjen e vendimeve të caktuara që kërkojnë aftësi të caktuara, të cilat mund të fitohen vetëm në sistemin formal të arsimit. Mësimi se si të kenë dialog me njerëz me respekt, vlerat e të cilëve ndryshojnë nga vlerat e veta, është me rëndësi të madhe për procesin demokratik dhe për mbrojtjen dhe forcimin e demokracisë dhe për të kultivuar kulturën e të drejtave të njeriut.<sup>1</sup>

Nxënësit/et duhet të zhvillojnë ndjeshmëri ndaj temave të caktuara, por edhe empati ndaj viktimave të luftës, pavarësisht se cilës anë i përkasin ato viktimat. Kjo kërkon edhe narrativë tjetër. Nuk mjafton të thuhet se lufta u shkaktoi nga kriza në shoqëri dhe se pasoja e asaj lufte ishte krijimi i një sërë shtetesh të reja në territorin e ish-Jugosllavisë. Fatkeqësisht, pasojat janë të shumta dhe duhet kushtuar më shumë vëmendje në tekstet zyrtare dhe në klasë.

Studimi i temave kontroverze, siç janë konfliktet në territorin e ish-Jugosllavisë, është thelbësore për zhvillimin e mendimit kritik te të rinjtë. Megjithatë, studimi dhe diskutimi i kësaj teme është një sfidë për çdo mësues/se. Luftërat e viteve 1990 në këtë rajon janë një shembull klasik i një teme që përfshin një konflikt të madh interesash dhe vlerash me lidhje me pretendime të diskutueshme për ngjarje të caktuara, prandaj gjatë diskutimit është e vështirë të jepet përgjigje të thjeshta për këtë temë. Kjo është edhe pasojë e arsimit fillestar të pamjaftueshëm të mësuesve/eve në këtë fushë. Është fakt që studentët/et e historisë (dhe mësuesit/et e ardhshëm) nuk e studiojnë këtë temë sa duhet, ose më saktë aspak, gjë që i vën ata në siklet për t'u marrë me të në klasë. Megjithatë, përmirësimi i vazhdueshëm e bën trajtimin e kësaj teme një lloj domosdoshmërie. Përvoja praktike tregon se nxënësit/et më shpesh pyesin për konfliktin në Bosnje dhe Hercegovinë apo sulmin e vullnetarëve malazezë në Dubrovnik, sesa për zhvillimin e kulturës në hapësirën e disa prej civilizimeve të para. Gjithsesi, është përgjegjësi e mësuesit që t'u qaset në mënyrë profesionale dhe të përgjegjshme të gjitha temave të parashikuara nga kurrikulumit, veçanërisht sepse nxënësit/et janë më të interesuar për këtë temë sesa për të tjerat. Arsyeja për këtë është ndikimi i mediave, shoqërisë laike dhe faktorëve të tjerë që shpesh çojnë në nxjerrjen e përfundimeve të gabuara. Lënia e ndikimeve të tilla dhe mungesa e reagimit ndaj tyre nënkupton gjithashtu përgjegjësinë personale të mësuesit/ës, pra, në këtë rast, papërgjegjshmërinë. Mbyllja e syve përballë sfidave të caktuara nuk duhet të jetë karakteristikë e atyre që janë në procesin arsimor, veçanërisht mësuesve/eve të *Historisë*.

**Studimi i temave kontroverze, siç janë konfliktet në territorin e ish-Jugosllavisë, është thelbësore për zhvillimin e mendimit kritik te të rinjtë.**

<sup>1</sup> *Teaching Controversial Issues Through Education for Democratic Citizenship and Human Rights*, Training Pack for Teachers, Council of Europe, Jul 2016. Dostupno na: <https://rm.coe.int/16806948b6>. Pristupljeno: 20. 04. 2024.

Për shkak të këtyre faktorëve, duhet të kemi mirëkuptim ndaj mësuesve/eve të *Historisë*, të cilët nuk ndihen mjaft të përgatitur për t'u marrë me këtë temë në klasë, por kjo nuk mund të jetë gjithmonë alibi për të neglizhuar rolin edukativ në proceset me rëndësi për zhvillimin e shoqërisë. Luftërat e fundit në këto hapësira janë shembull ilustrues se si pas tyre duhet ndryshuar qëndrimin e opinionit publik dhe përfshirja e tyre në sistemin arsimor në mënyrë që ballafaqimi me temat kontroverze të bëhet pjesë e kurrikulës së detyrueshme.

Mësuesit/et e *Historisë* kanë për detyrë t'u ofrojnë nxënësve/eve mundësinë për të diskutuar për këtë dhe tema të ngjashme, sepse është e rëndësishme të dëgjohet zëri i brezave të rinj. Së bashku me ta e kemi për detyrë ta ndryshojmë shoqërinë për mirë, sepse së bashku e ndërtojmë. Në këtë kontekst, nevojat e tyre nuk duhet të neglizhohen dhe nevoja e tyre është të dinë diçka më shumë për konfliktet e fundit. Përndryshe, burimet kryesore të tyre njohëse për këtë dhe tema të ngjashme do të jenë konkluzionet e nxituara, të paverifikuara dhe të njëanshme, të bëra me qëllim që njëra apo tjetra palë të justifikojë pjesëmarrjen e tyre në ngjarje të caktuara. Duke i lënë kështu në (mos)mëshirën e ndikimeve të ndryshme negative, u mohohet një nga nevojat e tyre kryesore, që është nevoja për dije, si për të njohur faktet, ashtu edhe për t'i kuptuar dhe shpjeguar ato.

Nëpërmjet mësimi të çështjeve kontroverze, nxënësit/et kanë mundësinë të dalin nga zona e tyre e komoditetit, dhe kjo është arsyeja pse kjo ndryshon nga qasja e zakonshme përmes së cilës u prezantohet një korpus i caktuar njohurish që në përgjithësi nuk i inkurajojnë ata të mendojnë më thellë për realitetin historik.

Theksi duhet vënë edhe tek kultura e kujtesës, e cila, kur bëhet fjalë për luftërat e viteve 90-ta, shpesh neglizhohet. Për shkak të narrativave jashtëzakonisht të forta kombëtare që janë bërë pjesë e kurrikulës së *Historisë* në zonën e ish-Jugosllavisë, është gjithashtu e qartë se narrativa historike është kryesisht e harmonizuar me narrativat politike. Vendet e vuajtjeve dhe kultura e komemorimit nuk përfaqësohen mjaftueshëm edhe sot në narrativat historike, dhe nxënësit/et mbeten të privuar nga më shumë njohuri për to.

Ne, përmes mësimi të historisë së viteve '90, duhet të përballemi së bashku me të kaluarën, por më e rëndësishmja është që kjo e kaluar të njihet dhe pranohet fillimisht. Pajtimi në rajon është i pamundur pa njohjen reciproke të vuajtjeve të së kaluarës, por edhe pa ndryshime në qëndrimet që shpeshherë mund të jenë destruktive.

Për shkak të gjithë kësaj, *Historia* si lëndë mësimore në shkollë ka për obligim që t'i përkushtohet kësaj teme në mënyrë gjithëpërfshirëse. Dhe jo në përfundim të arsimit fillestar (sepse kjo temë trajtohet si një nga të fundit), kur nxënësit/et nuk kanë përqendrim dhe dëshirë të mjaftueshme për t'u përkushtuar detyrave të tyre shkollore, por sa herë që u jepet mundësia. Dhe mundësia gjithmonë mund të krijohet, sepse nxënësit/et janë gjithmonë të gatshëm të diskutojnë tema që nuk janë aq të thjeshta, dhe mbrojtja e pretenduar nga e vërteta mund t'u shkaktojë atyre vetëm dëme shtesë. Trajtimi i këtyre temave në mënyrë të duhur kontribuon në promovimin e paqes dhe vlerave qytetare dhe për këtë arsye imponohet si e domosdoshme. Të mos anashkalojmë rëndësinë e historisë, sepse siç shkruante Robert Heinlein, “brezi që injoron historinë nuk ka të kaluar dhe as të ardhme”.

# Konteksti juridik ndërkombëtar

Në territorin e ish-Jugosllavisë, gjatë viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, ndodhën një sërë konfliktesh, të cilat lanë pas pasojë të mëdha ekonomike, sociale dhe politike, që sollën edhe vuajtjen e një numri të madh njerëzish, në radhë të parë të popullsisë civile. Në këto konflikte morën pjesë një numër i madh i qytetarëve malazezë, kryesisht përmes ushtrisë rezervë të Ushtrisë Popullore Jugosllave (APJ), më vonë Ushtrisë së Jugosllavisë, por edhe njësisive të ndryshme vullnetare dhe paraushtarake. Rezervistët malazezë u mobilizuan dhe u vendosën në fronte të ndryshme anembanë ish-Jugosllavisë, duke përfshirë Kroacinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, si dhe Kosovën.

Pjesëmarrja e qytetarëve malazezë në operacionet luftarake pati ndikim në zonën ku ata vepronin, si në aspektin e humbjeve njerëzore ashtu edhe përmes krimeve të shumta të luftës që më vonë u bënë objekt i procedurave gjyqësore dhe hulumtimeve. Është e nevojshme të kujtojmë paraqitjen e “luftëtarëve të fundjavës”, d.m.th vullnetarëve nga Mali i Zi që morën pjesë në plaçkitjen e objekteve civile dhe në krime të tjera lufte në zonën e Foçës dhe në vende të tjera në Bosnjën dhe Hercegovinën lindore, afër kufirit me Malin e Zi gjatë viteve 1992-1993.<sup>2</sup> Paralelisht me luftërat në territorin e ish-Jugosllavisë, pjesëtarët e policisë malazeze dhe të Ushtrisë Jugosllave kryen aksione në territorin e Malit të Zi që më vonë do të karakterizoheshin si krime lufte.

Gjatë konflikteve të lartpërmendura, është krijuar nevoja për procesin penal të krimeve të luftës të kryera gjatë këtyre konflikteve. Në këtë drejtim, pika kthese u arrit në maj të vitit 1993 me themelimin e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, me synim për t’u përgjigjur mizorive masive që po ndodhnin në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë në atë kohë. TPNJ ishte gjykata e parë për krimet e luftës e themeluar nga Kombet e Bashkuara (OKB), si dhe gjykata e parë ndërkombëtare për krimet e luftës pas gjykatave të Nurembergut dhe Tokios.<sup>3</sup>


Mali i Zi, si pjesë e bashkimit shtetëror të Serbisë dhe Malit të Zi, në vitin 2003 nënshkroi Ligjin

<sup>2</sup> Ivanisheviq Bogdan dhe Gorjanc Preleviq Tea, *Gjyqet për krime lufte në Mal të Zi (2009-2015)*, Aksioni për të Drejtat e Njeriut., Podgoricë, 2016, fq. 7. Në dispozicion në: <https://www.hraction.org/wp-content/uploads/2017/05/Sudjenja-za-ratne-zlocine-u-Crnoj-Gori-2009-2015.pdf>. Aksesuar me: 05.05.2024.

<sup>3</sup> TPNJ | Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Në dispozicion në: <https://www.icty.org/bcs/o-mksj>. Aksesuar me 10. 04. 2024.

për Bashkëpunimin e Serbisë dhe Malit të Zi me Tribunalin Ndërkombëtar për ndjekjen penale të personave përgjegjëse për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e ish Jugosllavisë nga viti 1991, në të cilën thuhet qartë se vendimet gjyqësore të Gjykatës Ndërkombëtare Penale do të respektohen dhe zbatohen dhe do t’u ofrohet ndihmë juridike organeve të saj hetuese dhe gjyqësore.<sup>4</sup>



 Osnivanje MKSJ<sup>5</sup>

Mali i Zi ka nënshkruar një sërë konventash, si Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit (miratuar në vitin 1948), e cila konfirmon qartë se “...se gjenocidi, pavarësisht nëse është kryer gjatë paqes apo luftës, është krim sipas të drejtës ndërkombëtare.” prandaj shteti i Malit të Zi si nënshkruar është i obliguar ta parandalojë dhe ta ndëshkojë këtë krim.<sup>6</sup> Përveç kësaj, Mali i Zi është nënshkruar i Konventa për Paparashkrueshmërinë e Krimeve të Luftës dhe të Krimeve kundër Njerëzimit nga viti 1968,<sup>7</sup> Konventa kundër torturës dhe dënimeve dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare nga viti 1998<sup>8</sup> dhe një sërë dokumentesh të tjera.

<sup>4</sup> Më shumë për këtë ligj në: [https://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Member\\_States\\_Cooperation/implementation\\_legislation\\_scg\\_bcs.pdf](https://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Member_States_Cooperation/implementation_legislation_scg_bcs.pdf)

<sup>5</sup> *Savjet bezbjednosti UN-a je 25. maja 1993. donio rezoluciju 827 kojom se osniva Međunarodni krivični sud za bivšu Jugoslaviju. Fotografija je vlasništvo MKSJ-a i dostupna je na:* <https://www.flickr.com/photos/icty/14649781527/in/photostream/>

<sup>6</sup> Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit. Në dispozicion në: <https://media.cgo-cce.org/2013/06/12-Konvencija-o-sprijecavanju-i-kaznjavanju-zlocina-genocida.pdf>. Aksesuar me 16.03. 2024.

<sup>7</sup> Më shumë në: <https://wapi.gov.me/download/10a4fa76-a550-4436-ad12-429283b48e44?version=1.0>

<sup>8</sup> Më shumë në: <https://www.icc-cpi.int/sites/default/files/RS-Eng.pdf>

Me Nenin 9 të Kushtetutës së Malit të Zi është rregulluar rendi juridik. Kushtetuta përcakton se traktatet ndërkombëtare të konfirmuara dhe të publikuara si dhe rregullat e pranuar gjerësisht të së drejtës ndërkombëtare, janë pjesë përbërëse e rendit të brendshëm juridik dhe kanë përparësi ndaj legjislacionit vendas, duke u zbatuar drejtpërdrejt kur rregullojnë marrëdhënie ndryshe nga legjislacioni i brendshëm.

Për më tepër, Kodi Penal i Malit të Zi përcakton krimet e luftës dhe përshkruan bazat për përgjegjësinë penale. Kodi i Procedurës Penale i Malit të Zi është vendimtar për ndjekjen penale të krimeve të luftës, duke siguruar kornizën ligjore për gjykim të drejtë dhe ndjekjen penale efektive të autorëve. Ligji për Prokurorinë të Shtetit dhe Ligji për Prokurorinë Speciale të Shtetit ofrojnë bazën për vendosjen e kornizës institucionale të Malit të Zi për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës, duke përfshirë njësitë e specializuara për punuar me Prokurorinë Speciale të Shtetit (PSS).<sup>9</sup>

PSS, e formuar në vitin 2015, përfaqëson një institucion shumë të rëndësishëm në luftën kundër formave më të rënda të krimit, përfshirë krimet e luftës. Me një gamë të gjerë kompetencash, PSS-ja luan rolin kyç në hetime, ndjekjen penale dhe ndjekjen penale të individëve të dyshuar për kryerjen e krimeve të luftës gjatë konflikteve të armatosura. Departamenti i Policisë Speciale, i cili punon në bashkëpunim me PSS-në, është hallkë e rëndësishme në hetimin e krimeve të luftës në Mal të Zi, si një departament i specializuar në hetime komplekse që përfshijnë krimet e luftës, krimin e organizuar, korrupsionin dhe terrorizmin.<sup>10</sup>

Këto fakte theksohen sepse në territorin e Malit të Zi kanë ndodhur një sërë krimesh gjatë luftërave të viteve 1990 në të cilat janë shkelur konventat e përmendura dhe vetëm një pjesë e tyre, që do të trajtohen në këtë doracak, kanë marrë epilogun gjyqësor.

<sup>9</sup> Zbatimi i Strategjisë për Hetimin e Krimeve të Luftës të Prokurorisë së Shtetit të Malit të Zi (2015-2021), Aksioni për të Drejtat e Njeriut, Podgoricë 2021, fq. 3. Në dispozicion në: [https://www.hraction.org/wp-content/uploads/2021/06/Izvjestaj-o-primjeni-Strategije\\_FINAL.pdf](https://www.hraction.org/wp-content/uploads/2021/06/Izvjestaj-o-primjeni-Strategije_FINAL.pdf). Aksesuar me: 14. 05. 2024.

<sup>10</sup> Njësoj.

# Mali i Zi dhe luftërat e viteve 1990 – konteksti historik

Mali i Zi priti fillimin e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe vitin 1991 turbulent me qeverinë e parë të zgjedhur në zgjedhjet shumëpartiake. Zgjedhjet përfaqësuan kulmin e procesit që filloi në verën e vitit 1988, pra një sërë ngjarjesh që në pushtet në Mal të Zi do të konsolidojnë strukturat politike besnike ndaj lidërshiptit politik të Serbisë në atë kohë, përkatësisht Slobodan Millosheviqit. Pas një sërë demonstratash, të cilat fillimisht u mbajtën nën sloganin e mbrojtjes së bashkatdhetarëve të pambrojtur në Kosovë, dhe më pas për kërkesat e pretenduara sociale, në janar të vitit 1989, nën presionin e demonstruesve, i gjithë lidërshipti politik dhe shtetëror i Malit të Zi dha dorëheqjen.<sup>11</sup>

Gjenerata e re politike, udhëhequr nga Momir Bullatović, Milo Gjukanović, Svetozar Marović dhe të tjerë, ishte Lidhja e Komunistëve të Malit të Zi (LKMZ) në zgjedhjet e dhjetorit të vitit 1990, duke fituar 56.2% të votave nga ata që dolën në zgjedhje. Në të njëjtën kohë me zgjedhjet parlamentare u mbajtën edhe zgjedhjet e para për kryetar të Presidencës së Republikës së Malit të Zi, ku me një numër bindës votash pas raundit të dytë u zgjodh Momir Bullatović. Në qershor të vitit 1991, LKMZ do të ndryshojë emrin e saj në Partinë Demokratike të Socialistëve të Malit të Zi (PDS).<sup>12</sup>

Zgjedhjet e dhjetorit të vitit 1990 forcuan pushtetin e politikanëve që erdhën në krye të shtetit me grushtin e shtetit të vitit 1989. Kjo udhëheqje ndoqi ambiciet politike dhe ushtarake të Beogradit gjë që pati si rezultat mbështetjen e qëndrimit të udhëheqjes së ushtrisë nga marsi i vitit 1991 për vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme. Ajo politikë do të vazhdojë me të njëjtin qëndrim edhe ndaj çështjes së shpalljes së pavarësisë së Sllovenisë dhe ndaj “luftës dhjetëditore”.<sup>13</sup>

Në planin e brendshëm, nga mesi i vitit 1991, Mali i Zi kishte pastruar tashmë të paaftët dhe të

<sup>11</sup> Më shumë se ngjarjet gjatë Revolucionit Antiburokratik dhe grushtit të shtetit të vitit 1988/1989 në Sh. Rastoder dhe N. Axhiq, *Historia moderne e Malit të Zi 1988-2017*, Libri I. Daily Press, Vijesti, 2020.

<sup>12</sup> Grup autorësh, *Zgjedhjet dhe legjislacioni zgjedhor në Mal të Zi 1990 - 2006*, CEMI, 2007, fq. 25.

<sup>13</sup> Sh. Rastoder i N. Axhiq, *Historia moderne e Malit të Zi 1988-2017*, Libri II. Daily Press, Vijesti, 2020, fq. 502.

pabesët në administratën shtetërore, por edhe në shtëpitë mediatike shtetërore, të cilat në fakt mbanin monopol mbi hapësirën mediatike.<sup>14</sup> Retorika nacionaliste u intensifikua në media, fillimisht ndaj sllovenëve, dhe menjëherë pas referendimit kroat për pavarësinë dhe shpalljes së Sarajevës se do të ndiqte të njëjtën rrugë, ajo narrative u shndërrua në narrative antikroate dhe antimuslimane. Përveç kësaj, që nga fillimi i vitit 1991, Radio Televizioni Titograd (me vonë Radio Televizioni i Malit të Zi) dhe gazeta Pobjeda kanë intensifikuar fushatën kundër politikanëve/eve dhe aktivistëve/eve të opozitës.

Korriku dhe gushti i vitit 1991 në Mal të Zi kaluan me mobilizimin e përbërjes rezervë të anëtarëve të APJ-së dhe histerinë e luftës mediatike. Propaganda e luftës përbëhej nga teza që varionin nga mbrojtja e unitetit të Jugosllavisë, deri te shpallja e kroatëve si komb gjenocidal dhe Kroacisë si krijim gjenocidal. Me kalimin e kohës, mbrojtja e Jugosllavisë u plotësua më qartë me elementë serbomadhe, kufijtë e rinj potencialë u u bënë më të qarta dhe të gjithë që kundërshtonin mbrojtjen agresive dhe ushtarake të atyre ideve u shpallën tradhtarë dhe ustasha.<sup>15</sup>

Ndërsa zgjaste histeria e luftës, me 17 korrik, në Titograd u mbajt mitingu i parë kundër luftës në Jugosllavi. Rreth 5000 qytetarë/e të Malit të Zi, organizatorë/re u çuan kundër fashizmit të shoqërisë. Bartës të protestit ishin partitë opozitare me orientim qytetar që ishin në koalicionin Aleanca e Forcave Reformuese – Aleanca Liberale e Malit të Zi, Partia e Socialistëve, Partia Socialdemokrate e Malit të Zi, Organizata e Pavarur e Komunistëve, Partia e Barazisë Kombëtare dhe Alternativa Demokratike. Në mbështetje të tyre kanë qenë edhe Qendra PEN malazeze, Lëvizja Qytetare për Paqe, Lidhja Studentore për Paqe, Këshilli malazez i Lëvizjes Evropiane, si dhe revistat e pavarura të sapothemeluara Monitor dhe Liberal etj.

Gjatë shtatorit të vitit 1991, në Pobjedë (Pobjeda) filluan të shfaqen indikacione se mund të vinte deri tek konflikti. Kulmi ndodhi më 20 shtator, kur u publikua një raport dramatik se Kroacia po vendoste forca të reja në kufi me Malin e Zi, se situata ishte e ndezshme dhe se po përgatitej një sulm në kazermën e APJ-së në Prevlacë.<sup>16</sup> Natën mes 20 dhe 21 shtatorit, njësitë e mobilizuara të rezervistëve malazezë hynë në Hercegovinën lindore, në të njëjtën ditë kur Mali i Zi u shpall shtet

<sup>14</sup> Zh. Andrijasheviq, Sh. Rastoder, *Historia e Malit të Zi*, CICG, 2006, fq. 490.

<sup>15</sup> Zhivko M. Andrijasheviq, *Projekt për ideologjinë e një qeverie*, Conteco, 1999.

<sup>16</sup> *Njësoj*.

**Ndërsa zgjaste histeria e luftës, me 17 korrik, në Titograd u mbajt mitingu i parë kundër luftës në Jugosllavi. Rreth 5000 qytetarë/e të Malit të Zi, organizatorë/re u çuan kundër fashizmit të shoqërisë**

ekologjik. Së shpejti erdhi te konflikti në zonën e Konavllës, si parathënie e operacioneve kryesore që do të kryheshin në këtë zonë. Kulmi i operacioneve të luftës ishte rrethimi i Dubrovnikut, i cili zgjati nga 1 tetori 1991 deri më 31 maj 1992. Shumica e rezervistëve të APJ-së që morën pjesë në sulmin në këtë zonë vinin nga Mali i Zi. Në operacionet në front të Dubrovnikut dhe Hercegovinës humbën jetën 165 ushtarë nga Mali i Zi, ndërsa 236 persona morën statusin si invalid të luftës.<sup>17</sup>

Përveç kësaj, Dubrovniku, si qytet në Listën e Trashëgimisë Kulturore Botërore të UNESCO-s, pësoi një shkatërrim të madh, kështu që krimet kundër trashëgimisë kulturore në Dubrovnik me vonë u përcaktuan para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) si krime kundër njerëzimit.

Për krimet e kryera në këtë zonë, para TPNJ-së janë iniciuar katër lëndë, përkatësisht: Prokurori kundër Miodrag Jokiq – “DUBROVNIK” (IT-01-42/1)<sup>18</sup>, Prokurori kundër Vladimir Kovaçević – “Dubrovnik” (IT-01-42/2)<sup>19</sup>, prokurori kundër Pavle Strugar – “Dubrovnik” (IT-01-42)<sup>20</sup>, si dhe rasti kundër Slobodan Millosheviqit, i cili përfshinte edhe zona të tjera, dhe i cili u ndërpre për shkak të vdekjes së të akuzuarit.

Para Tribunalit të Hagës për krime lufte të kryera gjatë sulmit në Dubrovnik u dënuan ish gjenerali i JNA-së Pavle Strugar dhe komandanti i tij i nënshtruar Miodrag Jokiq. Para Tribunalit të Hagës u akuzua edhe admiral i pensionuar Millan Zec, por ai u shpall i pafajshëm në vitin 2002, ndërsa edhe kapiteni i akuzuar i klasit të parë të JNA-së, Vladimir Kovaçević – Rambo, u lirua përkohësisht në vitin 2004 për shkak të trajtimit mjekësor me vendim të Tribunalit të Hagës.<sup>21</sup>

Gjenerali Strugar u dorëzua vullnetarisht në Tribunalin e Hagës në dhjetor të vitit 2001 dhe ishte në lirim të përkohshëm deri në dhjetor të vitit 2003. Në janar të vitit 2005, Strugar u dënua me tetë vjet burg për granatimin e qytetit të vjetër të Dubrovnikut më 6 dhjetor të 1991, nga pozicioni i grupit të dytë operativ të APJ-së, të cilin e komandonte. Më parë, zëvendësadmiralet Miodrag Jokiq, komandanti i Sektorit Detar të Bokës, i nënshtruar i Strugarit, e pranoi fajin për atë sulm para gjykatës. Jokiq u dënua me shtatë vjet burg dhe më pas dëshmoi kundër Strugarit. Strugari edhe pas shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë është liruar përkohësisht në Mal të Zi për arsye shëndetësore. Nga Mali i Zi ai u ankua ndaj vendimit. Më 17 korrik 2008, Tribunali në Hagë dënoi gjeneralin në pension të APJ-së, Pavle Strugar, me shtatë vjet e gjysmë burg për granatimin e qytetit

<sup>17</sup> *Historia e Malit të Zi*, fq. 490.

<sup>18</sup> Të dhënat për lëndën “Dubrovnik” (IT-01-42/1) Miodrag Jokiq. Në disponim në: [https://www.icty.org/x/cases/miodrag\\_jokic/cis/bcs/cis\\_miodrag\\_jokic\\_bcs.pdf](https://www.icty.org/x/cases/miodrag_jokic/cis/bcs/cis_miodrag_jokic_bcs.pdf). Aksesuar me: 10.05.2024.

<sup>19</sup> Të dhënat për lëndën „Dubrovnik” (IT-01-42/2) Vladimir Kovaçević. Në disponim në: [https://www.icty.org/x/cases/kovacevic\\_vladimir/cis/bcs/cis\\_kovacevic\\_vladimir\\_BCS.pdf](https://www.icty.org/x/cases/kovacevic_vladimir/cis/bcs/cis_kovacevic_vladimir_BCS.pdf). Aksesuar me: 10.05.2024.

<sup>20</sup> Të dhënat për lëndën “Dubrovnik” (IT-01-42) Pavle Strugar. Në disponim në: [https://www.icty.org/x/cases/strugar/cis/bcs/cis\\_strugar\\_bcs\\_1.pdf](https://www.icty.org/x/cases/strugar/cis/bcs/cis_strugar_bcs_1.pdf). Aksesuar me: 10.05.2024.

<sup>21</sup> *Gjyqet për krime të luftës në Mal të Zi (2009-2015)*, fq. 11.

të vjetër në Dubrovnik në dhjetor 1991, duke ulur kështu dënimin e shkallës së parë me gjysmë viti.<sup>22</sup> Gjenerali Strugar u dënua për vepra penale: sulme ndaj civilëve; shkatërrim ose dëmtim i qëllimshëm i institucioneve të destinuara për fe, qëllime bamirësie dhe arsimit, arti dhe shkencës, monumentet historike dhe veprat e artit dhe shkencës, shkatërrimi i pajustifikuar nga nevoja ushtarake, sulmet ilegale ndaj objekteve civile (shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës).<sup>23</sup>

Gjatë agresionit të APJ-së, ushtrisë së ish-Jugosllavisë dhe rezervistëve malazezë në Konavle dhe Dubrovnik në vitin 1991, nga kjo zonë burrat të kombësisë kroate u sollën dhe u burgosën. Ata u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe u keqtrajtuuan sistematikisht në kampin Morinj në Bokë.

Ndërsa konflikti në Kroaci ishte ndezur, pas një sërë përpjekjesh të bashkësisë ndërkombëtare të sigurojë shpërbërjen paqësore të Jugosllavisë, në fillim të vitit 1992, në Bosnje dhe Hercegovinë (BiH) dhe në Mal të Zi u organizuan referendume për statusin shtetëror-juridik. Udhëheqja malazeze, nën presionin e Beogradit dhe forcave të forta pro-serbe brenda Malit të Zi, u përmbajt nga përpjekjet për pavarësi në mënyrën se si bënë republikat e tjera jugosllave. Disa historianë besojnë se opsioni i pavarësisë mund të ketë qenë jorealist në rrethanat e dhëna dhe se nisja e asaj iniciative të tillë mund të çonte në konflikt.<sup>24</sup>

Në kushte të tilla të brendshme politike, Mali i Zi organizoi referendumin. Deklarata që u mbajt më 1 mars 1992 u organizua për pak më shumë se një javë. Pyetja në referendum ishte: *A jeni pro që Mali i Zi, si Republikë sovranë, të vazhdojë të jetojë në bashkësi të përbashkët - Jugosllavi, krejtësisht të barabartë me republikat e tjera që dëshirojnë ta bëjnë këtë?* Sipas rezultateve të publikuara, në referendum kanë marrë pjesë 66,04% e votuesve dhe prej tyre PO ka rumbullaksuar 95,94%. Sipas rezultateve të këtij referendumi, Mali i Zi ishte i vetmi nga të gjitha republikat e tjera që vendosi të mbetet në bashkim me Serbinë dhe të formojë një shtet të ri - Republikën Federale të Jugosllavisë (RFJ). Ndryshe nga Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina do të vendosë për pavarësinë në referendumin e organizuar në të njëjtën ditë me Malin e Zi. Më pak se një muaj nga shpallja e rezultateve të referendumit, ky vend do të përfshihet në luftë.

Kushtetuta e re e Malit të Zi u miratua më 12 tetor 1992. Mali i Zi definohet si shtet i popullit malazez, shtet demokratik, social dhe ekologjik, sovran në çështjet që nuk i ka kaluar në juridiksionin e RFJ-së.

Ndërsa Mali i Zi u integrua në Jugosllavinë e re, më të vogël, lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë shpërtheu. Në maj të vitit 1992, RFJ u përjashtua nga organizatat ndërkombëtare për shkak të pjesëmarrjes së saj në luftërat në rajon dhe ndaj saj u vendosën sanksione ekonomike, të cilat shkatërruan ekonominë e Serbisë dhe Malit të Zi.<sup>25</sup> Edhe pse zyrtarisht njësitë nga Mali i Zi nuk morën pjesë në luftën në BiH, qytetarët malazezë ishin anëtarë të njësisë të ndryshme vullnetare dhe paraushtarake dhe Republika e Malit të Zi dërgoi mbështetje materiale për forcat serbe të Bosnjës.

---

<sup>22</sup> Të dhënat për lëndën „Dubrovnik“ (IT-01-42).

<sup>23</sup> Njësoj.

<sup>24</sup> *Historia e Mali të Zi*, fq. 488.

<sup>25</sup> Njësoj.

Fatkeqësisht, konflikti në Bosnje dhe Hercegovinë çoi në ngjarje tragjike edhe në Mal të Zi. Në maj të vitit 1992, refugjatët nga Bosnja dhe Hercegovina, të cilët u përpoqën të gjenin shpëtimin në Mal të Zi nga shkatërrimi i luftës dhe mobilizimi, u kthyen në mënyrë sistematike dhe u dëbuan. Gjatë të njëjtit konflikt, në zonën e Bukovicës, në komunën e Plevlës, pjesëtarët e policisë dhe ushtrisë malazeze kanë kryer një sërë krimesh kundër popullatës rezidente boshnjake. Përveç këtyre rasteve, të cilat më vonë do të përkufizohen si rasti i Deportimit dhe rasti i Bukovicës, ka pasur edhe krime individuale, si rrëmbimi dhe vrasja e një pasagjeri në stacionin e Shtërpçit dhe vrasja e familjes Klapuh.

Konfliktet në Kroaci dhe BiH përfunduan në vitin 1995. Por në vitin 1996, në Kosovë pati tensione të reja midis Ushtrisë Jugosllave, policisë së Republikës së Serbisë dhe forcave lokale shqiptare të Kosovës, që do të përshkallëzojnë në konflikt të hapur në vitin 1998. Mbase negociatat politike në Rambuje dhe Paris dështuan, më 24 mars 1999, 19 anëtarë të NATO-s ndërmorën një fushatë bombardimi kundër RFJ-së. Bombardimi përfundoi më 10 qershor, me miratimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Sipas vlerësimeve, 10 persona kanë humbur jetën gjatë bombardimeve të NATO-s në territorin e Malit të Zi. Gjatë bombardimeve të NATO-s të urës në qytetin e Murinos më 30 prill 1999, u vranë gjashtë civilë, duke përfshirë tre fëmijë. Ende nuk është përcaktuar numri përfundimtar i qytetarëve/eve të Malit të Zi, të cilët kanë humbur jetën gjatë konfliktit në Kosovë dhe bombardimit të NATO-s. Si gjatë konflikteve të mëparshme ashtu edhe gjatë konfliktit në Kosovë, qytetarët e Malit të Zi ishin pjesë e forcave ushtarake dhe policore që morën pjesë në krimet e luftës.

Pavarësisht kësaj, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve/eve të Kosovës ende kërkuan strehim në Mal të Zi. Fatkeqësisht, gjatë disa kalimeve të kolonave të refugjatëve nëpër zonën malore nga Kosova në Mal të Zi, Ushtria Jugosllave ka qëlluar mbi refugjatët. Krimet e luftës të kryera gjatë këtyre incidenteve njihen si rasti Kallugjerski laz.

Pavarësisht situatës së vështirë ekonomike që i ndodhi, Mali i Zi u siguroi strehim refugjatëve nga zonat e prekura nga konfliktet e luftës dhe trazirat (Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova). Në vitin 1999, Komisariati për Personat e Zhvendosur regjistroi 136,812 persona që gjetën strehim në Mal të Zi. Rreth 80,000 refugjatë kanë ardhur nga Kosova në të njëjtin vit. Pothuajse çdo i gjashtë banor i Malit të Zi në atë kohë ishte refugjat<sup>26</sup>, gjë që ishte një barrë e madhe në raport me numrin e banorëve.

---

<sup>26</sup> Njësoj.



# Luftërat e vitit 1990 në sistemin arsimor malazez

Shpërbërja e Jugosllavisë dhe luftërat që shoqëruan këtë proces janë përfaqësuar në sistemin arsimor malazez që nga fillimi i viteve 2000. Por, ka shumë diskutime se si trajtohet kjo temë, sa mësohet në të vërtetë dhe cila është marrëdhënia me episodet më të ndjeshme të konfliktit.

Në tekstin shkollor për klasën e IX përmendet sulmi në Dubrovnik, si dhe lufta në Bosnje-Hercegovinë dhe Kroaci. Megjithatë, nuk përmendet asnjë krim i kryer nga qytetarët malazezë gjatë asaj periudhe, madje as në fushën e betejës së Dubrovnikut.<sup>27</sup>

Në tekstin për klasën e IV të gjimnazit është trajtuar më hollësisht shpërbërja e Jugosllavisë dhe një kapitull i veçantë titullohet „Mali i Zi në kohën e zhdukjes së Jugosllavisë 1991-2000”. Gjithsesi, nuk përmendet asnjë krim luftar i vetëm i kryer në territorin e Malit të Zi, ndërsa sulmi në Dubrovnik është i vendosur në kapitullin e mëparshëm „Zhdukja e Jugosllavisë dhe Lufta Civile” me shpjegimin se është sulmuar nga APJ pa deklaruar asnjë lidhje me Malin e Zi.<sup>28</sup> Nxënësve u mohohet informacioni duke mos përmendur rolin e Malit të Zi në luftën në territorin e ish-Jugosllavisë, si dhe krimet në territorin e tij. Udhëzimet shkencore për mësimin e ngjarjeve të kontroverse nga e kaluara, përveç krijimit të një tabloje të plotë, nënkuptojnë edhe dhënien e një gjykimi me vlerë të arritur nga shkenca historike, shteti dhe gjykatat. Duke pasur parasysh se institucionet malazeze dhe ato ndërkombëtare kanë kohë që janë deklaruar dhe duke pasur vlerësimin e tyre për ngjarjet kryesore, mbetet e paqartë pse këto ngjarje nuk përmenden.

Kjo do të thotë se tekstet shkollore dhe programet mësimore të lëndës *Historia* në Mal të Zi nuk trajtojnë mjaftueshëm pjesëmarrjen e Malit të Zi në luftërat e viteve 1990. Edhe pse përfshijnë fakte dhe ngjarje themelore nga ajo periudhë, shpesh mungojnë analizat me detaje dhe rishikimet kritike të rolit të Malit të Zi në ato konflikte. Në këtë mënyrë, nxënësit/et krijojnë një tablo jo të plotë të periudhës së caktuar dhe nuk fitojnë një shqyrtim të plotë të një pjese të rëndësishme të historisë

moderne të vendit të tyre. Kjo qasje mund të ndikojë në të kuptuarit e proceseve historike dhe e vështirëson përballjen me të kaluarën.

Theksi në temën e luftërave të viteve 1990 mund të vihej edhe në lëndë të tilla si *Edukata Qytetare*. Brenda kësaj teme, ka hapsirë për një trajtim më të detajuar të pjesëmarrjes së Malit të Zi në konfliktet e luftës, por edhe për trajtimin e procesit të pajtimit, të drejtave të njeriut dhe drejtësisë tranzicionale. Duke i integruar këto tema në lëndë, nxënësit/et do të fitonin një perspektivë më të gjerë dhe kuptim më të thellë të çështjeve komplekse historike dhe sociale, gjë që do të kontribuojnë në ndërtimin e të menduarit kritik dhe qytetarisë së përgjegjshme.

Në katalogun e lëndëve zgjedhore për arsimin fillor, Këshilli Kombëtar i Arsimit ka miratuar një sërë lëndësh, ku përfshihet *Hulumtimi i së Drejtës Humanitare*, i cili mësohet në klasat VIII dhe IX të shkollës fillore. Promovimi i kësaj lënde në shkollat fillore do të mund të tejkalonte disa mangësi që ekzistojnë aktualisht kur bëhet fjalë për mësimin e krimeve të luftës të kryera në territorin e Malit të Zi në fund të shekullit të kaluar. Përkufizimi i lëndës sqaron pozicionin, natyrën dhe qëllimin e lëndës dhe shpjegon qartë se është një program arsimor ndërkombëtar që “i referohet të drejtës ndërkombëtare humanitare, e cila përfshin pjesën e së drejtës ndërkombëtare publike që mbron viktimat e konflikteve të armatosura dhe ruan dinjitetin njerëzor në të gjitha llojet dhe format e konflikteve të armatosura, por edhe menjëherë pas tyre. Programi është i dedikuar për të rinjtë nga 13 deri në 18 vjeç, me qëllim njohjen me rregullat që sigurojnë mbrojtjen e jetës dhe dinjitetit njerëzor në kushtet e konflikteve të armatosura...”<sup>29</sup> Gjithashtu, brenda 34 orëve, që janë planifikuar gjatë vitit shkollor, renditen një sërë rezultatesh arsimore, të cilat përfshijnë shembuj dallues të shkëlqejve të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare (DNH) dhe rregullave bazë të DNH-së, duke vlerësuar rëndësinë e dinjitetit njerëzor në situata luftarake etj. Kjo çon në përfundimin se natyra e kësaj lënde është në përputhje me mësimin e temës që trajtojmë dhe se ky doracak do të ketë një rëndësi të madhe për mësuesit/et që japin këtë lëndë. Kjo theksohet edhe sepse një pjesë e burimeve të përdorura në përgatitjen e këtij doracakut bazohen në arritjet e TPNJ-së, të cilat, siç thuhet në faqen e tyre zyrtare, përfshijnë<sup>30</sup>:

- Precedentët ligjorë të krijuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë kanë zgjeruar kufijtë e së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe penale, si në çështjet materiale ashtu edhe në ato procedurale;
- Gjykata Ndërkombëtare vendosi ndalim të përgjithshëm të torturës në drejtën ndërkombëtare që nuk mund të shmanget nga traktati, ligji kombëtar ose në ndonjë mënyrë tjetër;
- Gjykata Ndërkombëtare ka arritur përparim të rëndësishëm në të drejtën ndërkombëtare humanitare në lidhje me rregullimin ligjor dhe dënimin e dhunës seksuale në luftë.

<sup>27</sup> Slavko Burzanović, Jasmina Gjorgjević, *Historia për klasën e IX të shkollës fillore*, ZUNS, Podgoricë, 2015, fq. 132.

<sup>28</sup> Milan Shqeqiq, Zhivko Andrijashević, Vanja Vuković, *Historia, tekst shkollor për klasën e katërt të shkollës së mesme*, ZUNS, Podgoricë, 2015, fq. 164.

<sup>29</sup> Më shumë rreth programit lëndor në: <https://www.gov.me/dokumenta/906d9801-8b4f-4987-89cf-a2efcff931aa>

<sup>30</sup> Më shumë rreth arritjeve të TPNJ-së në: <https://www.icty.org/mk/node/8501#jacanje>

# Krimet e luftes të viteve 1990 në vendimet e gjyqësorit malazez - shembuj praktik për mësuesit

Para drejtësisë malazeze janë paraqitur një numër çështjesh që lidhen me krimet e luftës të kryera në territorin e Malit të Zi gjatë luftërave të viteve '90 të shekullit të kaluar, si dhe jashtë territorit të tij, duke përfshirë qytetarët malazezë si viktime dhe si kryerës të atyre krimeve. Drejtësia malazeze ende përballet me sfida në ndjekjen penale të shumë çështjeve, veçanërisht atyre që lidhen me pjesëmarrjen e qytetarëve të Malit të Zi në krimet e kryera në territorin e shteteve fqinje. Prandaj, ky doracak fokusohet në krimet që kanë marrë një epilog gjyqësor, duke theksuar se, edhe pse në disa çështje nuk është përcaktuar përgjegjësia individuale e kryerësve, nëpërmjet materialeve provuese dhe dëshmimeve të të dëmtuarve dhe familjeve të tyre, është e padiskutueshme që krimet kanë ndodhur. Gjithashtu, doracaku bën një vështrim mbi interpretimin e atyre krimeve nga ana e gjykatave.

Fokusi i doracakut është vetëm në rastet e krimeve të luftës të proceduara në Mal të Zi. Deri më tani, në Mal të Zi janë proceduar gjithsej shtatë raste të krimeve të luftës. Këto krime rezultuan me vdekjen e më shumë se njëqind personave dhe një numër akoma më i madh pësuan pasoja të drejtpërdrejta. Në disa raste, të akuzuarit u gjykuan në mungesë dhe nuk u mbajtën kurrë përgjegjës për krimet për të cilat u dënuan përfundimisht. Shembulli më i mirë për këtë është vrasja e familjes Klapuh. Përgjegjësia është vendosur vetëm në katër raste, për gjithsej 11 kryes, ndërsa 26 të akuzuar janë liruar. Shtatë persona u dënuan, mes tyre katër për krime kundër të burgosurve të luftës në kampin Morinj, një për krime lufte kundër popullatës civile për shkak të vrasjes së anëtarëve të familjes Klapuh (katër të akuzuar në këtë rast u dënuan në mungesë), një për pjesëmarrje në kidnapimin dhe vrasjen e njëzet udhëtarëve nga treni në stacionin e Shtërpçit dhe një për vrasjen e katër civilëve në Kosovë. Të gjithë të akuzuarit për spastrim etnik në Bukovicë, në kufirin e Malit të Zi dhe Bosnjë e Hercegovinës, për arrestimin dhe deportimin e paligjshëm të refugjatëve në ushtrinë e Republikës

së Sërbisë dhe për vrasjen e civilëve në Kallugjerski laz, janë liruar nga përgjegjësia. Në tre raste, gjykatat malazeze nuk i ka cilësuar veprimet si krime lufte, pavarësisht se viktimat e këtyre krimeve janë të padiskutueshme.<sup>31</sup>

Maurizio Salustro, ish-prokurori shtetëror dhe gjykatës nga Italia, i cili u angazhua nga Komisioni Evropian si ekspert për të analizuar punën e prokurorisë dhe gjykatave malazeze në ndjekjen penale të krimeve të luftës, deklaroi në vitin 2014 se prokurorët e shtetit malazez, nga fitimi i pavarësisë nuk kanë filluar asnjë hetim për krimet e luftës me iniciativë të vet. Ai përmendi mungesën e një qasjeje strategjike ndaj hetimeve dhe ndjekjes penale të krimeve të luftës si një përfundim kyç. Kritikoi qasjen e prokurorëve të shtetit në rastet e Deportimit dhe Bukovicës dhe propozoi miratimin e një strategjie që do të përfshinte veprimet e nevojshme për të përmirësuar hetimin e krimeve të luftës, duke përfshirë identifikimin e të gjitha krimeve të dyshuara të luftës të kryera nga qytetarët malazezë duke përdorur të gjitha burimet e disponueshme.<sup>32</sup>

Në vitin 2015, PSS mori përgjegjësinë për krimet e luftës nga Zyra e Prokurorit të Lartë të Shtetit (PLS), Departamenti për Shtypjen e Krimet të Organizuar, Korrupsionit, Terrorizmit dhe Krimeve të Luftës, i cili ishte përgjegjës për ndjekjen penale të krimeve të luftës nga viti 2008 e deri atëherë. 14 raste në lidhje me krimet e luftës janë aktualisht në pritje pranë PLS-së. Hetimet janë duke u zhvilluar në 12 raste, ndërsa një rast është në fazën hetimore. Po ashtu, në Gjykatën e Lartë në Podgoricë është në proces procedura kundër një personi, e nisur me aktakuzën e PLS-së nga 22 tetori i vitit 2021. Aktakuza është ngritur kundër një shtetasi malazez për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile nga neni 142 paragrafi 1 i Kodit Penal të RFJ-së (vrasja e dy civilëve dhe përdhunimi i një gruaje me nacionalitet boshnjak) për vepër penale të kryer në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës. Aktakuza është vërtetuar dhe procedura është në fazën e shqyrtimit gjyqësor.<sup>33</sup>

Gjithashtu, këtu nuk do të merremi në detaje me krimin e ndodhur në qytetin e Murinos më 30 prill të vitit 1999, sepse për të nuk është zhvilluar asnjë procedurë penale, pavarësisht se gjatë bombardimit të urës në këtë vend gjashtë civilë u vranë nga forcat e NATO-s, dhe ata janë Miroslav Knezheviq (14), Olivera Maksimoviq (13), Julija Brudar (11), Vukiq Vuletiq (46), Milka Koçanoviq (69) dhe Manojlo Komatina (72), ndërsa katër persona janë lënduar rëndë.<sup>34</sup>

<sup>31</sup> *Kundër harresës - deklaratat e dëshmitarëve në gjyqet për krime lufte. Aksioni për të Drejtat e Njeriut*, Podgoricë, 2021, fq. 7-8. Në dispozicion në: <https://www.hracion.org/wp-content/uploads/2021/11/Protiv-zaborava-za-web-1.pdf>. Akseluar me: 02.05.2024.

<sup>32</sup> *Zbatimi i Strategjisë për Hetimin e Krimeve të Luftës të Prokurorisë së Shtetit të Malit të Zi (2015-2021)*, fq. 2.

<sup>33</sup> *Platforma për pjesëmarrjen e delegacionit malazez në mbledhjen e XIII të Komitetit të Stabilizim Asociimit*, 21.02.2024, Ministria e punëve të jashtme. Në dispozicion në: <https://wapi.gov.me/download-preview/77564963-afe5-440e-8bcc-6fa563f41b6b?version=1.0>. Akseluar me: 25.05.2024.

<sup>34</sup> *Njëzet e pesë vjet nga bombardimi i NATO-s në Murin: familje ende pa kompensim dhe pa statusin e viktimeve civile të luftës, Aksioni për të Drejtat e Njeriut*. Në dispozicion në: <https://www.hracion.org/2024/04/29/25-godina-od-nato-bombardovanja-murina-porodice-i-dalje-bez-obestecenja-i-bez-statusa-civilne-zrtve-rata/>. Akseluar me: 15.05.2021.



➔ Ura e shembur ne Murin<sup>35</sup>

Familjet e prekura nga bombardimet paditën shtetin për dëmshpërblim, duke deklaruar se nuk ishin paralajmëruar për rrezikun, pavarësisht se NATO-ja njoftoi paraprakisht autoritetet për objektivat e planifikuara. Megjithatë, Gjykata Supreme e Malit të Zi e ka refuzuar kërkesën për dëmshpërblim për shkak të parashkrimit të pretenduar të kërkesës, pasi nuk ka filluar asnjë procedurë penale kundër atyre që është dashur t'i informojnë qytetarët për kërcënimin.

Madje, në një rast që është zhvilluar para drejtësisë malazeze për dëmshpërblim, familjes së Manojlo Komatinës i është shqiptuar dëmshpërblim prej 69.000€ dhe 6.500€ për shpenzimet e procedurës, të cilat i janë paguar familjes. Megjithatë, Gjykata e Lartë konstatoi se familja Komatina nuk kishte të drejtën e kompensimit për dëmin që i ishte paguar, bazuar në qëndrimin kufizues se gjykatat civile nuk mund të përcaktojnë nëse dëmi është si pasojë e një veprë penale apo jo, të gjitha për të aplikuar një vjetrim afatgjatë. Gjithashtu, të gjithë të tjerëve që kërkuan dëmshpërblim nga shteti, kërkesat e tyre u rrëzuan menjëherë si të vjetra. Në këtë mënyrë, çështja e dëmshpërblimit për familjet e qytetarëve malazezë të vdekur gjatë bombardimeve në vitin 1999 dhe statusi i të plagosurve me atë rast mbetet një pyetje e hapur dhe sfidë për autoritetet në Mal të Zi në periudhën e ardhshme.<sup>36</sup>

Puna në këtë temë është shumë e rëndësishme jo vetëm për qasjen në të kaluarën, por për formimin e perceptimit historik bazuar në informacionin e marrë përmes hulumtimit kritik dhe reflektimit. Duke qenë se drejtësia tranzicionale dhe arsimit janë procese të pandashme, ky doracak synon të sjellë

<sup>35</sup> Foto e shkarkuar nga: <https://rtcg.me/hronika/549565/od-stradanja-civila-u-murinu-25-godina-zlocin-bez-kazne.html>

<sup>36</sup> Dëmshpërblimi për viktimat e krimeve të luftës në Mal të Zi, Aksioni për të Drejtat e Njeriut, Podgoricë, 2016, fq. 29-30. Në dispozicion në: <https://www.hracion.org/wp-content/uploads/2016/12/Izvjestaj-NaknadaStete-FINAL.pdf>. Aksesuar me: 18.04.2024.; Njëzet e pesë vjet nga bombardimi i NATO-s në Murin: familje ende pa kompensim dhe pa statusin e viktimave civile të luftës.

një segment kyç të drejtësisë tranzicionale në Mal të Zi më afër procesit arsimor historik. Qëllimi i një qasjeje të tillë nuk është vetëm formimi i pikëpamjeve të bazuara në fakte të përcaktuara gjyqësore, por edhe nxitja e aftësive të të menduarit kritik që nevojiten për t'u përballur me të kaluarën e afërt dhe të vështirë, e cila ende ndihet në shoqërinë bashkëkohore në të gjithë rajonin.

Në bazë të përvojës së fituar në punën me këto tema, autorët janë të mendimit se dëshmitë e të dëmtuarve janë burimi më i vlefshëm për mësuesit/et, përveç gjykimeve, ndaj është bërë përpjekje që përmes dëshmimeve dhe gjykimeve të merret një mjet i dobishëm që do t'i ndihmojë ata të përpujnë këtë temë në klasë.

## Rasti kampi Morinj

Gjatë konflikteve në territorin e ish-Jugosllavisë në vitet 1990, u krijuan një sërë kampesh edhe vende të tjera të paraburgimit, ku u kryen krime të rënda. Shumica e këtyre kampeve, të cilat ishin kryesisht të përqendruara ose ushtarake, ishin të vendosura në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës, ndërsa një numër i caktuar ndodheshin edhe në vende të tjera, veçanërisht në Kroaci dhe Serbi. Ajo që shpesh anashkalohet është fakti se një nga kampet ndodhej në territorin e Malit të Zi, në vendin Morinj.

Kur u themelua, në nëntor të vitit 1991, kampi në Morinj ishte menduar të shërbente si „qendër grumbullimi për pranimin e të burgosurve të luftës”. E vërteta, siç do të dëshmohej, ishte shumë ndryshe. As nuk ishte qendër grumbullimi dhe as nuk shërbente vetëm për pranimin e të burgosurve të luftës. Kampi në Morinj shërbeu si vend ku zbatoheshin tortura fizike dhe psikologjike mbi të burgosurit dhe funksionoi deri në gusht të vitit 1992, kur u mbyll. Sipas të dhënave që mund të gjenden në *Monografinë e të Burgosurve të Dubrovnikut*<sup>37</sup>, nëpër kampin në Morinj kaluan gjithsej 312 të burgosur me kombësi kroate, gjysma e të cilëve ishin civilë. Megjithatë, lista e individëve të burgosur përfshin 270 emra, ndërsa në aktakuzë nuk është përmendur numri i përgjithshëm i të dëmtuarve, por është propozuar që 161 persona të dëgjohen si dëshmitarë. Në vendime nuk është përmendur numri i përgjithshëm i të burgosurve.<sup>38</sup>

Gjithashtu, në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe raportit të autopsisë, është konstatuar se „të lënduarit Brailo Miho, Çagal Antun dhe Obrad Jakov kanë ndërruar jetë derisa ndodheshin në Qendër, ndërsa vdekja e të plagosurit Obrad ka ardhur si pasojë e vetëvrasjes me varje, ndërsa të plagosurit Kraj Miho, Ban Bozho dhe Brailo Vlaho vdiqën pasi u larguan nga Qendra.” Në Monografi thuhet se tetë të burgosur vdiqën nga torturat dhe keqtrajtimi në kampe dhe dhjetëra vdiqën më vonë nga pasojat.<sup>39</sup>

<sup>37</sup> *Monografia e të Burgosurve të Dubrovnikut*, ur. Zdenko Buliq, Shoqata Kroate e të burgosurve të kampeve serbe të përqendrimit, Dega e Qarkut Dubrovnik-Neretva, Dubrovnik, 2011, fq. 19.

<sup>38</sup> *Gjyqet për krime lufte në Mal të Zi (2009-2015)*, fq. 19.

<sup>39</sup> *Monografia e të Burgosurve të Dubrovnikut*, str. 162.

Të arrestuarit e parë u sollën në kamp më 3 nëntor të vitit 1991, gjë që është e rëndësishme të theksohet, duke marrë parasysh se sulmi i forcave të APJ-së ndaj Dubrovnikut dhe zonave përreth filloi vetëm një muaj më parë. Atëherë, synimi për të sjellë disa nga të burgosurit në territorin e Malit të Zi ishte i dukshëm. Nuk dihet se çfarë ka ndodhur në tre objektet ku mbaheshin prej kohësh të arrestuarit. Edhe ish-kryeprokurorja e Malit të Zi, Vesna Medenica, ka deklaruar se për ekzistencën e kampit ka dëgjuar për të parën herë në vitin 2003 nga kolegët e saj kroatë, dhe pas kësaj është nënshkruar marrëveshja me Kroacinë për ndjekjen penale të të burgosurve të luftës, në bazë të të cilës provat të mbledhura nga prokuroria kroate i janë dorëzuar prokurorisë së Malit të Zi për këtë rast.<sup>40</sup>

Edhe pse aktakuza në këtë rast do të ngrihet më shumë se pesëmbëdhjetë vjet pasi ajo ka pushuar së funksionuari, krimet në Morinj janë përmendur disa herë para TPNJ-së.

Kështu, Marko Knezhiq dëshmoi për kushtet në Morinj para TPNJ-së, në lëndën Milosheviq Slobodan (IT-02-54).<sup>41</sup> Një kroat nga fshati Slano afër Dubrovnikut, i cili u kap nga forcat e APJ-së në dhjetor 1991, përkundër faktit se ai kurrë nuk u akuzua për ndonjë krim të caktuar, u dërgua në kampin Bileqa, nga ku u dërgua në maj të vitit të ardhshëm me pretekstin se do të shkëmbehej së bashku me rreth njëqind të burgosur të tjerë, u transferua në kampin në Morinj. Duke e krahasuar kampin në Morinj me atë të Bileqës, Knezhiq deklaroi se kushtet ishin më të këqija, megjithëse nuk kishte punë të detyruar, por kishte abuzime të vazhdueshme fizike dhe psikologjike. Të burgosurit rriheshin nëse refuzonin të këndonin këngë serbe kur shkonin në tualet (kjo është arsyeja pse shumë refuzuan ta përdornin atë për shumë ditë), dhe dita kur Knezhiq u kujtua për brutalitetin më të madh ishte 13 qershori 1992, kur ushtarët me uniformë i rrahën për katër orë pa u ndalur. Knezhiqit iu thyen dy brinjë dhe, dhe siç ka deklaruar, brutalitetin më të madh e përjetoi në duart e ushtarit të quajtur Boro Gligiq, i cili gjithashtu ishte një nga të dënuarit në gjyqësorin malazez. Është interesant fakti që Knezhiq ishte i bindur se torturat në të dy kampet ku ishte ai, ishin të urdhëruara nga oficerët e APJ-së, sepse siç tha: „Duke qenë se të dy komandantët (të kampit të Bileqit dhe të kampit Morinj) ishin nga APJ-ja, ato kampe ishin të administruara nga APJ. Jam plotësisht i bindur se këto kampe nuk mund të krijoheshin pa miratimin paraprak të komandës së lartë të APJ-së dhe se gjithçka që ndodhte në kampe ishte bërë me aprovimin e tyre”. Knezhiq u mbajt në Morinje deri më 2 korrik, kur më në fund u lirua pas shkëmbimit të të burgosurve.<sup>42</sup>

Në rastin e përmendur kundër Slobodan Milosheviqit, dëshmoi edhe kryetari i komunës së Dubrovnikut në kohën e luftës, Petar Polaniq, i cili, i pyetur për të burgosurit në Morinj, deklaroi se ata ishin kryesisht civilë, me përjashtim të disa ushtarëve që ndodheshin në Bileqa dhe më pas u transferuan nga Bileqa në Morinj, kështu që ai nuk mund të konkludonte se nuk kishte ushtarë në Morinj. Ai e dinte se disa ishin transferuar në Morinj, por sipas dëshmisë së tij, nga 300 personat në Morinj, jo më shumë se një e pesta ishin ushtarë.<sup>43</sup>

<sup>40</sup> Dënimi maksimal për krimet në Morinj është katër vjet burg, Radio Evropa e Lirë. Në dispozicion në: [https://www.slobodnaevropa.org/a/morinj\\_visi\\_sud\\_u\\_podgorici/2042899.html](https://www.slobodnaevropa.org/a/morinj_visi_sud_u_podgorici/2042899.html). Aksesuar me: 15.04.2024.

<sup>41</sup> Gjykimi i Slobodan Milosheviqit/Transkriptet. Në dispozicion në: [https://www.icty.org/x/file/About/OTP/Milosevic%20Feature/VOV/milosevic\\_marko\\_knezic\\_fulltestimony\\_bcs.pdf](https://www.icty.org/x/file/About/OTP/Milosevic%20Feature/VOV/milosevic_marko_knezic_fulltestimony_bcs.pdf). Aksesuar me: 04.05.2024.

<sup>42</sup> Marko Knezhiq | Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Në dispozicion në: <https://www.icty.org/bcs/content/marko-kne%C5%BEi%C4%87>. Aksesuar me: 10.04.2024.

<sup>43</sup> Dëshmia e Petar Polaniq në rastin Prokurori kundër Slobodan Milosheviqit. Në dispozicion në: [https://www.icty.org/x/cases/slobodan\\_milosevic/trans/en/021211ED.htm](https://www.icty.org/x/cases/slobodan_milosevic/trans/en/021211ED.htm). Aksesuar me: 13.04.2024.

Për krimet e kryera në kampin e Morinjit, në periudhën nga 3 tetor 1991 deri më 18 gusht 1992, janë akuzuar gjashtë persona: Ivo Gojnic, Shpiro Luçiq, Boro Gligiq, Zlatko Tarle, Ivo Menzalin dhe Sasha Radenovic. Procesi kryesor ka filluar me aktakuzën ndaj këtyre personave në gusht të vitit 2008.

Nga gjashtë të akuzuarit, me aktgjykim të Gjykatës së Lartë në Podgoricë në vitin 2013, i cili më vonë u vërtetua me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në vitin 2014, katër prej tyre, të cilët në atë kohë ishin pjesëtarë të rezervës së APJ-së në këtë kamp, ishin të dënuar përfundimisht. Ndër të dënuarve ishte edhe Boro Gligiq, i cili ishte roje në kamp dhe i cili u dënua me tre vjet burg. Me tre vjet burg u dënua edhe Shpiro Luçiq, i cili ishte polic ushtarak. Ivo Gojnic, i cili ishte i ngarkuar me detyrat administrative dhe të tremujorit, u dënua me dy vjet burg. Dënimi më i lartë u dha për Ivo Menzalin, i cili ishte kuzhinier në kamp, që u dënua me katër vjet burg. Në aktgjykim thuhej se personat e dënuar kanë shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare, veçanërisht Konventën III të Gjenezës dhe Protokollin II Shtesë, duke i trajtuar në mënyrë çnjerëzore të burgosurit e luftës. U konstatua se të burgosurit që u sollën nga zona e Dubrovnikut pësuan abuzim fizik dhe psikologjik, duke përfshirë rrahje, tortura dhe të shtëna të rreme. Të dënuarit janë gjithashtu të obliguar që bashkërisht t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale në vlerë prej 3.531€, ndërsa shpenzimet shtesë të procedurës i kanë paguar individualisht, përveç Boro Gligiqit, i cili ishte i liruar pjesërisht nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale, përkatësisht atyre që kanë të bëjnë me kompensimin e mbrojtësit është caktuar në detyrë zyrtare.<sup>44</sup>

Një tjetër nga ata që kaluan tmerret e kampit në Morinje, si dhe në atë të Bileqës, ishte Robert Hausviçka, i cili përshkroi procesin e dërgimit të të burgosurve nga kampi i Bileqës në kampin Morinj. Ai tha: „Na hipën në një autobus që kishte rreth pesëdhjetë ulëse dhe maksimumi njëzet në këmbë. Shtatëdhjetë veta mund të rrinë brenda, dhe ne ishim njëqind e pesëmbëdhjetë ose njëqind e gjashtëmbëdhjetë veta në autobus. U ulëm në njëri-tjetrin. Kur u nisëm, ata hynë brenda. Nga Trebinja deri në Morinj është dy orë rrugë, nëse jo më shumë, nuk na vranë, na vranë zotin në ne. Ishte fati im që isha ulur, ishim tre të ulur në një vend, me dy djem më të gjatë. Dhe ia dola të strukem, kështu që fitova, por jo aq sa disa të tjerë. Ky djaloshi pranë meje, gjaku i rridhte nga shpina nga rrahja me shkop. Vërtet i shkonte shumë gjak. Me të mbërritur në Morinj, ne u shkarkuam në rrugën kryesore, dhe nga rruga kryesore deri në ato barrake, ku ushtria e APJ-së mbante armë, furnizime dhe mallra, janë nja dyqind ose treqind metra. Ishte një breshëri me ushtarë, njerëz, pleq, gra, fëmijë. Të gjithë kishin diçka, nga shkopi deri te shufra. Ushtarët kishin pushkë, kundak. Të gjithë na rrahën, në ato tre, katërqind metra. Derisa u futëm në ato konvikte, pra në hapsirë të rregulluara për ne. Aty kishte kushte të ndryshme se në Bileqë...”<sup>45</sup>

Një nga dëshmitë për kushtet në Morinj e ka lënë Metodije Prkaçin, i cila ka qenë edhe një nga dëshmitarët në gjykimin para drejtësisë malazeze. Ai ka deklaruar se është kapur më 16 tetor 1991 në

<sup>44</sup> Procesi i ballafaqimit me të kaluarën në Mal të Zi - Rasti "Morinj", Qendra për Arsimim Qytetar, Podgoricë, 2014, fq. 299 -302. Në dispozicion në: <https://media.cgo-cce.org/2014/12/cgo-cce-proces-suocavanja-sa-prosloscu-u-cg-slucaj-morinj.pdf>. Aksesuar me: 10.04.2024.

<sup>45</sup> Ndjekja e krimeve të luftës - Garantimi i procesit të ballafaqimit me të kaluarën në Kroaci, Documenta - Qendra për ballafaqim me të kaluarën, Zagreb, 2014, fq. 419-420. Në dispozicion në: <https://documenta.hr/wp-content/uploads/2020/09/procesuiranje-ratnih-zlocina-FINAL.pdf>. Aksesuar me: 11.04.2024.

Cavtat dhe më pas është dërguar në Morinj, ku i është nënshtruar torturave të përditshme. Prkaçin ka deklaruar se për ta pyetur është marrë nga i përmenduri Shpiro Luçiq, të cilin e kishte njohur personalisht që më parë, madje disa herë kishte qenë mysafir në shtëpinë e tij. Luçiq, së bashku me rojet e tjerë, vazhdimisht e rrahën dhe e dhunuan, por, Prkaçini deklaroi disa herë se i kishte mbijetuar torturave më të rënda nga kuzhinieri në kamp, Ivo Menzalin, i cili përsëriste gjithmonë një fjali pas goditjeve: “Pse nuk je serb?”<sup>46</sup>



➤ Një nga objektet në Morinj ku u sollën të burgosurit nga fusha e betejës së Dubrovnikut nga viti 1991 deri në 1992<sup>47</sup>

Pas përfundimit të procesit për krimet e luftës të kryera në kampin Morinj, ka vazhduar procedura për kompensimin e dëmeve, të iniciuara nga 207 të burgosur të lënduar të këtij kampi.

Sipas raportit të Aksionit për të Drejtat e Njeriut: „...Gjykata e Lartë e Malit të Zi ka përcaktuar se vetëm civilët kanë të drejtën e kompensimit për heqjen e pajustificuar të lirisë, jo të burgosurit e luftës, sepse gjatë një konflikti të armatosur është legjitime kapja e pjesëtarëve të forcave të armatosura të palëve në konflikt. Të burgosurve të luftës u jepej vetëm dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar nga tortura apo trajtime të tjera çnjerëzore apo poshtëruese, në ato raste kur vërtetohej një dëm i tillë... Shumat e dëmshpërblimit për dhimbjet fizike dhe shpirtërore të pësuar si pasojë e shkeljes së të drejtave personale nga tortura, trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruese e kishte vlerën prej 6,000 € deri në maksimum 18,000 €. Gjykata ka marrë parasysh kohën e qëndrimit të prokurorit në kamp, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjes shpirtërore dhe fizike dhe rrethanat e tjera të çështjes, si dhe praktikën gjyqësore në raste të ngjashme”. Në një numër të madh të lëndëve nuk është marrë vendimi i shkallës së parë, ndërsa në anën tjetër kanë ndërruar jetë shtatë të dëmtuarit,

<sup>46</sup> Rasti „Morinj” fq. 78.; Dëshmia e Metodije Prkaçin, Kujtimet personale, Documenta, Zagreb. Në dispozicion në: <https://www.osobnasjecanja.hr/video-arhiva/metodije-prkacin>. Aksesuar me: 11.04.2024.

<sup>47</sup> Fotografija je preuzeta sa: <https://www.slobodnaevropa.org/a/morinj-logor-crna-gora-ploca/32093271.html>

kështu që rastet e tyre për dëmshpërblim janë pezulluar.<sup>48</sup> Në qershor 2018, Mali i Zi ka paguar dëmshpërblim për abuzim dhe torturë në kampin Morinj në shumën prej 1.43 milionë €.<sup>49</sup>

Kampet e krijuara gjatë luftërave në territorin e ish-Jugosllavisë përfaqësojnë një nga simbolet e krimeve të luftës. Në edukimin historik dhe në kulturën e kujtesës, kampet si vende të vuajtjes së një numri të madh njerëzish kanë një rol specifik, veçanërisht për shkak të kompleksitetit të krimeve, jetës dhe vdekjes në to. Për më tepër, ndërtimi i marrëdhënieve të komunitetit lokal, shoqërisë dhe shtetit ndaj kampeve është sfidues, por i domosdoshëm për shërimin e traumave të luftës.

## Rasti Deportimi

Rasti Deportimi i referohet arrestimit të paligjshëm gjatë majit dhe qershorit të vitit 1992, dhe më pas dorëzimit në ushtrinë serbe të Bosnjës në BeH të të paktën 66 myslimanëve boshnjakë që ikën në territorin e Malit të Zi. Po ashtu, në atë periudhë, 33 refugjatë serbë nga BeH janë arrestuar dhe janë të kthyer në Republikën Srpska për shkak të mobilizimit, me theksimin se nuk është konstatuar se janë keqtrajtuar në asnjë mënyrë apo trajtuar si pengje në këtë proces dhe nuk dihet se ndonjëri prej tyre ka vdekur. Në këtë periudhë, qytetarët e BeH u përpoqën të gjenin shpëtimin në Mal të Zi nga shkatërrimi i luftës, terrori dhe mobilizimi i detyruar. Shumica e myslimanëve boshnjakë të deportuar u vranë, ndërsa vetëm 12 prej tyre arritën t'i mbijetonin ekstradimit. Qendra e Sigurisë Herceg Novi shërbente si një lloj qendre grumbullimi, nga ku këta refugjatë transportoheshin në mënyrë të organizuar. Numri më i madh i njerëzve u deportuan më 25 maj në kampin e Institucionit korrektues Foča dhe më 27 maj në lokacion të paspecifikuar në Bosnjën lindore. Të gjithë të deportuarit më 27 maj 1992 u vranë në të njëjtën ditë dhe dyshohet se trupat e tyre janë hedhur në lumin Drina. Përveç Herceg Novit, refugjatë u deportuan edhe nga Tivari, Podgorica, si dhe nga zonat afër kufirit me BeH.

Prokuroria e Shtetit e ka iniciuar hetimin më 18 tetor në vitin 2005, pra pas më shumë se 13 vitesh. Janë dëgjuar dhjetëra dëshmitarë, por ka kundërshtime të rënda për mënyrën e nisjes dhe zhvillimit të hetimit. Sipas interpretimit të ekspertëve ligjorë nga Aksioni për të Drejtat e Njeriut (HRA) të cilët u morën detajisht me këtë rast, „standardi ligjor i aplikuar në rastin e deportimit të refugjatëve nga Gjykata e Lartë në Podgoricë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë e Malit të Zi për të konstatuar se nuk është kryer asnjë krim lufte, është arbitrare, pra juridikisht e pabazuar. Asnjë nga këto gjykata nuk iu referua ndonjë burimi ligjor për të mbështetur pikëpamjen se të akuzuarit duhej t'i përkiste organizatës ushtarake, politike ose administrative të një pale në konflikt, ose të vepronte në shërbim të një pale në konflikt, në mënyrë që të jenë përgjegjës për krim lufte”. Këtë mendim e konfirmon edhe eksperti i Bashkimit Evropian, Maurizio Salustro, në analizën e tij për ndjekjen penale të krimeve

<sup>48</sup> Naknada štete žrtvama ratnih zločina u Crnoj Gori, str. 17.

<sup>49</sup> Izložba Stradanje i obnova Dubrovnika 1991. – 2000, Grad Dubrovnik. Dostupno na: [https://issuu.com/dubrovnik020/docs/dubrovnik\\_brosura\\_b\\_final\\_19092019?e=33617138%2F97910504](https://issuu.com/dubrovnik020/docs/dubrovnik_brosura_b_final_19092019?e=33617138%2F97910504). Pristupljeno 12.04.2024.

të luftës në Mal të Zi nga dhjetori i vitit 2014, duke gjykuar se ky qëndrim është „i paprecedentë” dhe „padyshim i gabuar”.<sup>50</sup>

Një nga ata që shpjegoi në dëshminë e tij se si shkoi procesi i deportimit ishte S.B. Përkatësisht, S.B. u strehua në Igalo me gruan e tij shtatzënë në vitin 1992, ku kishte shtëpinë. Mirëpo, ai u arrestua nga policia në Herceg Novi dhe më pas me një numër të madh njerëzish me autobus u transportua në Pluzhinë, prej nga u dërgua në Foçë. Asnjëherë nuk ka marrë të dhëna të sakta pse e kanë çuar në Foçë, por ka konstatuar se është i kërkuar për shkak të mobilizimit. Në fund, përmes menaxherit të Institucionit korrektues në Foçë dhe një ushtari ka arritur të njoftojë të atin për vendndodhjen e tij dhe i ati ka arritur ta nxjerrë jashtë.<sup>51</sup>

Gjithsej nëntë anëtarë të MPB-së u akuzuan për përndjekjen e refugjatëve boshnjakë nga Mali i Zi, por të gjithë u shpallën të pafajshëm. Gjegjesisht, më 29 mars 2011, Gjykata e Lartë në Podgoricë liroi nëntë të akuzuar, me arsyetimin se nuk u dëshmuar se ata i përkisnin forcave të armatosura të RFJ-së apo se kishin marrë pjesë në konflikt, kështu që veprimtaria e tyre nuk mund të konsiderohet shkelje e së drejtës ndërkombëtare. Gjykata e Apelit e Malit të Zi e rrëzoi këtë aktgjykim më 17 shkurt 2012 për shkak të paqartësive dhe kontradiktave, veçanërisht në lidhje me natyrën e konfliktit në BeH. Pas gjykimit të përsëritur, më 22 nëntor 2012, Gjykata e Lartë përsëri shpalli pafajësinë, por e anashkaloi pjesën për konfliktin e armatosur ndërmjet RFJ-së dhe forcave të Qeverisë së BeH. Më 17 maj 2013, Gjykata e Apelit e ka konfirmuar këtë aktgjykim.<sup>52</sup>

Kur i përket numrit të saktë të personave që janë deportuar nga territori i Malit të Zi në maj dhe qershor në vitin 1992, ka disa mosmarrëveshje. Gjegjesisht, në procedurën e zhvilluar në Gjykatën e Lartë në Podgoricë, është thënë se të akuzuarve është gjykuar për deportim për 52 persona gjithsej. Nga ana tjetër, ministri i atëhershëm i Punëve të Brendshme të Republikës së Malit të Zi, Nikolla Pejaković, në përgjigje të një pyetjeje parlamentare në vitin 1993, u përgjigj se numri ishte 66, dhe kjo i referohej konkretisht numrit të myslimanëve boshnjakë të deportuar. Në librin *Liria Fatale: Deportimi i refugjatëve boshnjakë nga Mali i Zi*, i autorit Sheki Radonçiq, theksohet se numri ishte dukshëm më i lartë dhe se gjithsej 105 refugjatë myslimanë boshnjakë u deportuan përsëri në BeH. Radonçiq përfshin këtu edhe njëzet boshnjakë, të cilët u sollën afër Nikshiqit me autobus nga Foça më 30 gusht 1992, por më pas i kthyen përsëri.<sup>53</sup> Ai gjithashtu thekson se pesë kroatë janë deportuar në periudhën maj-qershor 1992. Sipas Radonçiqit, në raportin e ministrit Pejaković mungonte një numër emrash, ku përfshihej edhe ish-kryetari i komunës së Srebrenicës, Malik Meholiq, i cili u arrestua në Tivar, si dhe një grua.

<sup>50</sup> Procesi i ballafaqimit me të kaluarën në Mal të Zi - Rasti „Deportimi,” Qendra për Arsimim Qytetar, Podgoricë, 2020, fq. 6. Në dispozicion në: <https://media.cgo-cce.org/2020/05/Slucaj-Deportacija.pdf>. Aksesuar me: 13.04.2024.; Gjyqet për krime lufte në Mal të Zi (2009-2015), fq. 30-31.

<sup>51</sup> Njësoj, fq. 87.

<sup>52</sup> Njësoj, fq. 6-7.

<sup>53</sup> Radonçiq, Sheki, *Liria Fatale: Deportimi i refugjatëve boshnjakë nga Mali i Zi*, Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, 2005, fq. 145. Në dispozicion në: [http://www.hlc-rdc.org/images/stories/publikacije/07\\_kobna\\_sloboda.pdf](http://www.hlc-rdc.org/images/stories/publikacije/07_kobna_sloboda.pdf). Aksesuar me: 10.04.2024.



Viktimat e deportimit<sup>54</sup>

Radonçiq po ashtu thekson se Zijad Veliq, i cili ishte oficer i pensionuar i APJ-së, u arrestua nga policia malazeze më 18 maj 1992 në kufirin me BeH dhe u deportua te kolegët nga Çajniqi. Në një dëshmi për mediat boshnjake<sup>55</sup>, bashkëshortja e tij Ismira, disa vite më vonë deklaroi: „...Zijadi u arrestua nga policia malazeze më 18 maj 1992 në pikën kufitare Metalka dhe menjëherë u dorëzua policëve nga Çajniqi. Pasi e kanë rrahur deri në vdekje atje, e kanë transferuar në spitalin e Plevlës. Pasi i përdora të gjitha lidhjet dhe njohjet me serbët, më lanë ta takoj. Koka e tij ishte e ënjtur e gjitha, e madhe, ndoshta nga goditjet e rënda. Një sy e kishte të kuqe si gjaku. Arriti të më thotë se i kanë vënë një kesë në kokë dhe se e kanë rrahur në Çajniq. Kur erdha ta vizitoj të nesërmen, më thanë se ai u ishte dorëzuar sërish policëve nga Çajniqi. Që atëherë nuk e kam parë. Në Gorazhdë, kanë informacione të marra nga të burgosurit serbë, se burri im është therur në një ish-shtëpizë gjuetie tre kilometra larg Çajniqit. Kam frikë se është e vërtetë”. Ismira mori konfirmimin për vdekjen e bashkëshortit të saj në fund të vitit 2002, kur eshtrat e Zijad Veliqit u gjetën në varrin masiv “Mostina” afër Çajniqit.<sup>56</sup>

Dëshmia e dëshmitares Zlata Kubat, e cila u dëgjua para gjykatës malazeze deklaroi se derisa po qëndronin në Sutomore si refugjatë, policia arrestoi bashkëshortin e saj Shevko dhe tre burra boshnjakë, e më pas babain e saj dhe atë. Zlata dhe babai i saj përfundimisht u liruan nga paraburgimi,

<sup>54</sup> Foto e shkarkuar nga: <https://www.hraccion.org/wp-content/uploads/2023/04/Deportacija-1280x592-1.jpeg>

<sup>55</sup> Intervistë nga gazeta „Dnevni avaz”, 26. gusht 1997.

<sup>56</sup> *Liria Fatale: Deportimi i refugjatëve boshnjakë nga Mali i Zi*, fq. 22.

por jo bashkëshorti i saj, të cilin nuk e panë kurrë më. Sipas policisë ai është dërguar në Herceg Novi. Zlata më vonë mori një letër nga bashkëshorti i saj nga Institucionit korrektues Foça, ku ishte deportuar, në të cilën ai përshkruante gjendjen e tij dhe theksonte se kishte probleme me ulcerë, e cila i shkaktoi vdekjen më 9 korrik 1993. Zlata pastaj kërkoi gjatë eshtrat e tij dhe fatkeqësisht, si në rastin e Zijad Veliqit, eshtrat e tij u gjetën në një varr, vetëm këtë herë në varrin e Patkovinës, midis Foçës dhe Ustikolinës.<sup>57</sup>

Fati i Shevko Kubatit mund të mësohet nga aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore në çështjen kundër Milorad Krnojelac,<sup>58</sup> ku në faqen 71 thuhet se Dhoma Gjyqësore: „...nuk është e bindur se prokuroria ka treguar se kushtet e jetesës në Institucionin Korrektues kanë qenë shkak thelbësor i vdekjes së Shefka Kubatit, e as që ngjarjet që kanë çuar në vdekjen e tij kanë ndodhur në kohën kur i akuzuari ka qenë drejtues...” Në këtë rast, i cili konkretisht kishte të bënte me krimet në Institucionin Korrektues Foça, trupi gjykues nuk u mor me dëbimin e Shevko Kubat nga Tivari në Foçe, por ky ishte juridiksioni i gjyqësorit malazez.

Me gjithë provat dhe dëshmitë, asnjë person në Mal të Zi nuk u dënua në këtë proces, i cili zgjati për disa vite.

Dhe dëshmitarja B.S. në dëshminë e saj para gjykatës, ka theksuar se ajo dhe bashkëshorti i saj janë strehuar në Mal të Zi, më saktë në Herceg Novi, duke besuar se atje do të jenë të sigurt nga ngjarjet e luftës. Mirëpo, një ditë, dy policë erdhën dhe ata e morën burrin e saj për bisedë informative. Burri i saj, të cilin ajo nuk do ta shohë më kurrë, u kthye në Srebrenicë. B.S. u përpoq të zbulonte se çfarë i kishte ndodhur dhe në fund ajo u njoftua në vitin 2003 se ai u gjet në Jami afër Bijelinës, por se më parë, në vitin 1992, e nxorën nga Drina dhe e varrosën afër fabrikës. B.S. vetëm pas një identifikimi të konfirmuar gati 15 vjet pasi burri i saj u zhduk, pati mundësinë të merrte eshtrat e tij.<sup>59</sup>

Kur është fjala për deportimin e refugjatëve, më shumë se dyqind njerëz paditën shtetin e Malit të Zi për kompensim, kështu që pas kthesave ligjore shumëvjeçare në vitin 2008, Qeveria e Malit të Zi vendosi të marrë një vendim për zgjidhjen gjyqësore në të gjitha lëndët që janë zhvilluar. Kjo ka rezultuar me pagesën totale të kompensimit në vlerë prej 4,135,000€, 30,000€ për fëmijët e viktimave, 25,000€ për prindërit dhe bashkëshortët, ndërsa 10,000€ për vëllezërit dhe motrat. Për një muaj robëri, të mbijetuarit janë paguar rreth 7.000 €, ose rreth 226€ në ditë. Në fakt edhe pas zgjidhjes janë iniciuar një numër i lëndëve të reja, për gjithsej 26 paditës, të cilëve u janë paguar 535,000€ shtesë.<sup>60</sup>

Rasti i Deportimit paraqet një nga krimet më komplekse të luftës që ka ndodhur në territorin e Malit

<sup>57</sup> Njësoj, fq. 30-31.; Rasti „Deportimi,” fq. 60.

<sup>58</sup> Informacionet për lëndën „FOÇA” (IT-97-25) Milorad Krnojelac. Në dispozicion në : [https://www.icty.org/x/cases/kjnojelac/cis/en/cis\\_kjnojelac\\_en.pdf](https://www.icty.org/x/cases/kjnojelac/cis/en/cis_kjnojelac_en.pdf). Aksesuar me: 14.05.2024.

<sup>59</sup> Rasti „Deportimi,” fq. 68.

<sup>60</sup> Kompensimi për dëmet e viktimave të krimeve të luftës në Mal të Zi, fq. 24-25.

të Zi gjatë viteve të 90-ta të shekullit të kaluar. Jo vetëm për shkak të aspekteve ligjore, politike dhe ndërkombëtare të vetë çështjes, por edhe për shkak të pasojave morale që ajo lë në shoqërinë malazeze. Fatkeqësisht, edhe ndërtimi adekuat i kulturës së përkujtimit u pengua për shkak të pengimit të çdo përpjekjeje për të shënuar vendin e krimit, si nga autoritetet lokale, ashtu edhe shtetërore, edhe pse shoqëria civile organizon një tubim përkujtimor në njëzet vitet e fundit. Që nga viti 2011, organizatat joqeveritare Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ), Aksioni për të Drejtat e Njeriut (HRA) dhe Qendra për Arsimimin e Grave dhe Paqes Kotorr (ANIMA) kanë avokuar për shpalljen e Ditës së Përkujtimit të Viktimave të krimit të deportimit të refugjatëve në vitin 1992 si dhe për ngritjen e një memoriali për ato viktime.<sup>61</sup>

## Krimet në Bukovicë

Zona e Bukovicës përfaqëson zonën malore të vendosur në veri të Malit të Zi, në komunën e Plevlës. Për kushtet malazeze, është një sipërfaqe e madhe, që përfshin 37 fshatra dhe shtrihet përgjatë kufirit të BeH. Deri në fillim të viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, ajo ishte e banuar kryesisht nga boshnjako-myslimanët, përkatësisht nga popullsia e fesë islame.

Gjatë konfliktit të armatosur në Bosnje dhe Hercegovinë, një numër i madh rezervistësh të Ushtrisë Jugosllave, policisë së Republikës së Malit të Zi dhe pjesëtarëve të formacioneve paraushtarake u përqendruan në territorin e Bukovicës. Arsyja zyrtare e grupimit të këtyre forcave në zonën e përmendur ishte patrullimi i kufirit për të parandaluar depërtimin e njërive paraushtarake myslimane nga BeH dhe kërkimin e armëve të fshehura. Sipas dëshmitëve të mbledhura nga organizatat joqeveritare për të drejtat e njeriut, gjatë qëndrimit të këtyre forcave në zonën e Bukovicës dhe kërkimit të armikut dhe armëve të fshehura, myslimanët e Bosnjës janë torturuar, kontrolluar, rrëmbyer, keqtrajtuar dhe abuzuar.<sup>62</sup>

Në librin “Bukovica 1992 – 1995 Pastrimi etnik, krimet dhe dhuna”<sup>63</sup> të Jakub Durgut thuhet se vetëm në vitin 1992 janë shpërngulur gjithsej 221 persona nga 24 fshatra, ndërsa nga viti 1992 deri në vitin 1995 janë vrarë gjashtë civilë, përkatësisht: Hajro Musliq, Ejub Musliq, Latif Bungur, Hilmo Drkenda, Xhafer Gjogo dhe Bijela Xhaka. Përveç kësaj, Durguti thekson se janë rrëmbyer 11 persona dhe se dy persona – Himzo Stovrag dhe Hamed Bavçiq – kanë kryer vetëvrasje si pasojë e torturave që u janë bërë. Durguti përmend edhe dëme të mëdha materiale, ku përfshihen djegia e tetë shtëpive dhe xhamisë së fshatit në fshatin Planjsko. Në botimin e QAQ-së “Procesi i ballafaqimit me të kaluarën në Mal të Zi - Rasti Bukovica” thuhet se krimet e kryera ndërmjet viteve 1992 dhe 1995 në Bukovicë çuan në shpërnguljen/

<sup>61</sup> Tridhjetë e dy vjet nga krimi i deportimit të refugjatëve - ftesë për tubim përkujtimor, Aksioni për të Drejtat e Njeriut, maj 2024. Në dispozicion në: <https://www.hracion.org/2024/05/24/32-godine-od-zlocina-deportacije-izbjeglica-poziv-na-memorijalno-okupljanje/>. Aksesuar me: 15.06.2024.

<sup>62</sup> Procesi i ballafaqimit me të kaluarën në Mal të Zi - Rasti Bukovica, Qendra për Arsimim Qytetar, Podgoricë, 2020, fq. 6. Në dispozicion në: <https://media.cgo-cce.org/2020/05/Slucaj-Bukovica.pdf>. Aksesuar me: 20.04.2024.

<sup>63</sup> Jakub Durgut, Bukovica 1992 – 1995 Pastrimi etnik, krimet dhe dhuna, Almanah, Podgoricë, 2003, fq. 5-7.

ikjen e 90 familjeve, me rreth 270 anëtarë.<sup>64</sup>

Në raportin e Aksionit për të Drejtat e Njeriut të vitit 2016, thuhet, bazuar në projektin e nisur nga Qeveria e Malit të Zi në vitin 2008, se një shumë prej gati 4.5 milionë € është ndarë për rindërtimin e 106 shtëpive të shkatërruara në zonën e Bukovicës, që përfshinte ndërtimin e objekteve banesore dhe ndihmëse, rehabilitimin e rrugëve, etj. Edhe pse u ndërtuan këto objekte, vetëm gjashtë familje u kthyen përfundimisht në Bukovicë.<sup>65</sup>

Aktakuza për krime lufte kundër njerëzimit u ngrit më 21 prill 2010, kundër vëllezërve Radmil dhe Radisha Gjukoviq, Slobodan Cvetković, Milorad Brković dhe Gjorgjij Gogiq, të cilët ishin pjesëtarë të forcave rezervë të Ushtrisë Jugosllave, dhe kundër Slavisha Svrkota dhe Radoman Shubariqa, pjesëtarë të forcave rezervë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Malit të Zi. Ata u akuzuan për trajtim çnjerëzor të popullatës civile myslimane, duke përfshirë torturën, dhunën, plaçkitjen, rrahjet, kërcënimet me vdekje dhe shkaktimin e vuajtjeve të rënda, të cilat rezultuan në emigrimin e popullatës myslimane nga Bukovica.

Gjykata e Lartë në Bijello Pole, në vendimin e saj të dhënë më 31 dhjetor 2010, arriti në përfundimin se nuk u vërtetua se veprimet e të akuzuarve ishin pjesë e një sulmi më të gjerë dhe sistematik dhe as që veprimet e tyre shkakton frikë në popullatën civile. Gjithashtu, gjykata thekson se nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë vepruar jashtë detyrave të tyre zyrtare dhe urdhrave të përditshme. Gjykata ka konstatuar se të akuzuarit janë shpallur të pafajshëm sepse ka mungesë provash.<sup>66</sup>

Ky aktgjykim i shkallës së parë u shfuqizua në qershor të vitit 2011 për arsye procedurale. Pas një rigjykimi, Gjykata e Lartë në Bijello Pole nxori një vendim më 3 tetor 2011, duke i liruar të akuzuarit për veprën penale të krimeve kundër njerëzimit. Prokuroria u ankua kundër këtij vendimi, por Gjykata e Apelit e Malit të Zi e refuzoi ankesën më 22 mars 2012 dhe e vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë. Prokuroria Supreme e Shtetit ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, e cila më 21 janar 2013 e ka refuzuar kërkesën si të pabazuar.<sup>67</sup>

Përveç faktit se askush nuk u mbajt përgjegjës për krimin në Bukovicë, çështja e përgjegjësisë komanduese nuk u hetua. Në hetim dhe në proces gjyqësor nuk janë përfshirë përgjegjësit sipas linjës komanduese, si dhe autorët e mundshëm të krimit. Mirëpo, dëshmitë e të mbijetuarve dhe viktimave, të cilët japin një pasqyrë të qartë të ngjarjeve në këtë zonë gjatë asaj periudhe, janë ato që flasin për krimet në Bukovicë. Njoftimi se lënda e re për Bukovicë do të ngrihet para PSS-së, bazuar në dosjet e dorëzuara nga prokurorët nga BeH, jep shpresë se drejtësia më në fund do të ia dalë.<sup>68</sup>

<sup>64</sup> Rasti „Bukovica“ fq. 6.

<sup>65</sup> Kompensimi për dëmet e viktimave të krimeve të luftës në Mal të Zi, fq. 20.

<sup>66</sup> Rasti „Bukovica“, fq. 59-63.

<sup>67</sup> Njësoj, fq. 6.

<sup>68</sup> Lela Shqepanović, *Prokurorët malazezë po hetojnë sërish krimin në Bukovicë*, Radio Evropa e Lirë, mars 2024. Në dispozicion në: <https://www.slobodnaevropa.org/a/crna-gora-ratni-zlocini-bukovica-vojska-tuzilastvo/32854036.html>. Aksesuar me: 15.05.2024.



 Mbetjet e xhamisë në fshatin Planjsko, të cilës iu vu zjarri më 19 prill 1993<sup>69</sup>

Njëri nga dëshmitarët, dhe i dëmtuari në këtë rast, T.H. ka deklaruar se është larguar nga fshati i tij nën presionin e formacioneve paraushtarake “*arkanovaca*” (të Arkanit) dhe “*sheshelevaca*” (të Sheshelit) në nëntor të vitit 1992, sepse e kanë kërcënuar “*të shpërngulet sepse këtu nuk ka jetë për ta*”. Pjesëtarët e njësiteve paraushtarake kanë dhunuar disa herë djalin e tij dhe atë, por edhe e kanë kërcënuar gruan e tij me fjalët “*tani do të vras, por nuk mund të ndyjmë plumbin*”. T.H. konfirmoi në dëshminë e tij se S.H u vetëvar pas disa ditësh për shkak të presionit të UJ-së dhe njësiteve paraushtarake dhe se Ejub dhe Hajro Musliq janë vranë, por nuk e di se kush e ka bërë. Dëshmitari nuk mundi të konfirmonte me siguri se kush e kishte dhunuar djalin e tij, përveçse nuk ishte Gj.R, i vetmi nga të akuzuarit të cilin e njohte.<sup>70</sup>

Jakub Durgut foli edhe për vdekjen e Hajros dhe djalit të tij Ejub Musliqit i cili deklaroi se u vranë në shtëpinë e tyre në fshatin Maxhari më 28 tetor 1992 dhe trupat e tyre u zbuluan nga Shemso Babiqi, një fqinj që e kishte të çuditshme se Musliqët nuk i lëshuan bagëtitë të kullosin. Shtëpia e Musliqëve dukej normale, vetëm se Babiqi vuri re një shishe ushtari të mbushur gjysmë me raki, e cila nuk i përkiste të vranëve.<sup>71</sup>

<sup>69</sup> Foto: Jakub Durgut

<sup>70</sup> Njësoj, fq. 42.

<sup>71</sup> Botimi: Dokumentet për të kaluarën - *Bukovica*, Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, 2003, fq. 39. Në dispozicion në: <https://hlc-rdc.org/wp-content/uploads/editor/Bukovica-srpski.pdf>. Aksesuar me: 21.04.2024.



Në atë periudhë, njësitë paraushtarake u përfaqësuan në një numër të madh në veri të Malit të Zi, veçanërisht në Plevla. Edhe presidenti i atëhershëm i Malit të Zi, Momir Bullatoviç, gjatë vizitës së tij në Plevla në maj të vitit 1992, konfirmoi se në zonën e asaj komune vepronin formacione paraushtarake, por edhe se kjo është e papranueshme.<sup>72</sup> Megjithatë, me gjithë përpjekjet e autoriteteve shtetërore për të çarmatosur të paktën pjesërisht këto njësi, kjo nuk ndodhi. Situata vetëm u përkeqësua dhe kulmon në zonën e Bukovicës, siç tregojnë dëshmitë.

Një nga historitë më tragjike ka ndodhur me familjen Bungur, të cilët u rrëmbyen dhe u transferuan në territorin e BeH. Së pari, më 15 shkurt 1993, në fshatin Krushevc, familja e Ramiza Bungurit, së bashku me katër anëtarë të tjerë të familjes (djali Mamko, nusja Zlatija dhe dy fëmijët e saj të mitur) u rrëmbyen nga personat me uniformë dhe u dërguan në burg në Çajniç, u burgosën për tre muaj e gjysmë, dhe më pas u shkëmbyen për luftëtarët serbë në Gorazhde.

Zlatija më vonë tha për vetë rrëmbimin: *“Disa ushtarë donin të më veçonin, ndoshta do të më kishin sulmuar, por njëri prej tyre nuk lejoi, mendoj se ishte një lloj oficeri. Gjatë rrugëtimit na shanin dhe na fyenin dhe Mamkon e vogël e goditën me shuplaka dhe e rrahën. Ende nuk e di se çfarë ka ndodhur më, sepse gjithë kujdesin dhe vëmendjen time e kam përqendruar te fëmijët e mi – që të mbesin gjallë”.*<sup>73</sup>

Vetëm një ditë pas rrëmbimit të familjes Ramiza Bungur, një rrëmbim praktikisht identike ndodhi në fshatin Ravni, ku gjashtë persona me mbiemër identik Bungur u rrëmbyen nga personat me uniformë, ndërsa më i madhi i Bungurëve, Latifi, u vra brutalisht. Njëra prej të rrëmbyurave, Sevda, ka deklaruar se atë mëngjes të 16 shkurtit e ka zgjuar zhurma dhe thyerja, e cila është shndërruar në abuzim fizik të familjarëve të saj, por edhe asaj.

Duke kujtuar ditën më të dhimbshme të jetës së saj, Sevda deklaroi: *“Në shtëpi isha vetëm dhe burri im Mushani në atë kohë punonte përkohësisht në Republikën Federale të Gjermanisë. Ushtarët na urdhëruan se duhet të shkojmë në Çajniçe, në BeH, e cila është rreth 15 km larg prej andej. Atëherë dëgjova se të gjithë ushtarët e pranishëm ishin nga Çajniçi dhe se Latif Bungur, rreth 90 vjeç, nuk mund të vinte me ne për shkak të moshës së tij. Me ne erdhi edhe gruaja e tij Lamka. Jam nisur zbathur dhe me pizhame, sepse nuk më linin të vishesha apo të mbathesha. Pas rreth 200 deri në 300 metra dëgjova një të shtënë nga pushka dhe menjëherë mendova se Latifi u vra. Rrugës për në Çajniç, nga ushtarët njoha Negja Mashiqin, i cili ishte fqinji ynë dhe e pyeta: “Çfarë po na bëni?”, dhe ai m'u përgjigj: “Mos të mos isha unë ti do të kishin vrrarë”.*<sup>74</sup>

Në bazë të dëshmimeve të përdorura dhe gjurmëve të qarta të persekutimit, mund të konstatohet se Bukovica është një tjetër në vargun e krimeve që kanë mbetur pa u ndëshkuar. Kjo ngjarje tragjike, fatkeqësisht, nuk është përfshirë siç duhet në planet dhe programet e sistemit arsimor malazez. Është e qartë se nxënësit/et në Mal të Zi nuk kanë mundësi të njohin hollësisht këtë pjesë të

<sup>72</sup> Njësoj, fq. 9.

<sup>73</sup> Njësoj, fq. 55.

<sup>74</sup> Njësoj, fq. 62.

historisë përmes kurrikulave formale. Në këtë mënyrë injorohen ngjarjet e rëndësishme, por edhe humbet mundësia për t'i mësuar brezit të ri rëndësinë e drejtësisë dhe përgjegjësisë për krimet e kryera dhe në ekstrem ju pengohet të zhvillojnë mendimin kritik dhe ndjeshmërinë ndaj viktimave përmes edukimit.

## Vrasja e familjes Klapuh

Vrasja e familjes Klapuh është një nga krimet më të rënda individuale të kryera në territorin e Malit të Zi në dekadën e fundit të shekullit të kaluar. Ekzekutimi mizor i tre anëtarëve të asaj familjeje, të cilët u vranë nga njerëz që duhej t'i ndihmonin, e bën këtë krim edhe më të tmerrshëm.

Me 6 korrik në vitin 1992 kur vendosën të largoheshin nga Foça, Hasani, gruaja e tij Ferida dhe vajza Sena i kërkuan Vidoj Golubiqit që t'i transferonte në territorin e Malit të Zi nëpërmjet Shqepan Pole. Golubiqit iu bashkuan Janko Janjiç, Zoran Vukoviç, Zoran Simoviç, Radomir Kovaç dhe Milomir Kovaç. Me tre makina, të gjithë u nisën për në Shqepan Pole. Për këtë shërbim rezultoi se Hasani u ka paguar xhelatëve të tij një shumë të caktuar parash.<sup>75</sup>

Kur kaluan kufirin me Malin e Zi, janë ndalur jo shumë larg digës së Mratinjës, ku, sipas gjetjeve të autopsisë, fillimisht është vrrarë Hasani, e më pas kanë qëlluar Feridën dhe Senën dhe i kanë shtyrë nga shkëmbi. Nga autopsia do të konstatohet se gratë fatkeqe kanë ndërruar jetë disa orë më vonë. Pas kryerjes së këtij krimi, vrasësit e familjes Klapuh shkuan në një kafene pranë. Trupat e familjes tre anëtarëshe u gjetën menjëherë pas krimit nga një punonjës i rrugës lokale, i cili e raportoi këtë në polici. Pas krahasimit të të dhënave nga pika kufitare, u konstatua se cilët ishin autorët e këtij krimi.<sup>76</sup>

Gjykimi që pasoi ishte një nga rastet e para në territorin e ish-Jugosllavisë ku u gjykua për krime lufte, gjë që u vërtetua me aktgjykimin përfundimtar. Për këtë vepër të akuzuar janë Janko Janjiç, Zoran Vukoviç, Zoran Simoviç, Radomir Kovaç dhe Vidoje Golubiq.<sup>77</sup> Meqenëse të gjithë përveç Golubiqit ishin në arrati, katër vrasësit u gjykuan në mungesë. Golubiq fillimisht u dënua me tetë muaj dënim për moskallëzimin e krimit, dhe më vonë u ndryshua në veprën penale të ndihmës së autorit pas kryerjes së krimit, me të njëjtin dënim. Të tjerët u dënuan me nga 20 vjet burg. Gjykata e shkallës së parë i karakterizoi këto krime si vrasje për interesin vetjak, por Gjykata Supreme e rrëzoi aktgjykimin dhe i karakterizoi këto vrasje si krime lufte.<sup>78</sup>

Në deklaratën që Golubiqi ka dhënë para Gjykatës së Lartë, tregon qartë se si janë kryer vrasjet: *“Menjëherë*

<sup>75</sup> Kundër harresës, fq. 57.

<sup>76</sup> Aktgjykimi i Gjykatës së Lartë Kzh.nr.114/94.

<sup>77</sup> Milomir Kovaçit, vëllaut të Radomir Kovaçit, nuk u gjykua edhe pse ai mori pjesë në këtë krim lufte, sepse kreu vetëvrasje vetëm disa javë pas.

<sup>78</sup> Aktgjykimi i Gjykatës së Lartë Kzh.nr.114/94.

pas largimit nga Foça, Janko Janjiq më tha se do të vriste Hasan Klapuh, sepse ai e kishte keqtrajtuar babanë e tij gjatë kohës që ai ishte duke punuar në Foçë dhe Klapuh mbante poste përgjegjëse.<sup>79</sup> Janjiq kishte ndërmend t'i vriste menjëherë pas largimit nga qyteti i Foçës, por unë e ndalova ta bënte këtë, duke e ditur se ai është i lehtë të tërheqë armën për një gjë të vogël. Nuk më lejuan të rezistoj fizikisht nga frika për jetën time... Kur mbërritme në urën e Obrad Cicmilit afër Shqepan Pole nga ora 16:00 deri në 17:00, Janko Janjiq më urdhëroi të ndaloja automjetin dhe më pas ndaloi Zoran Vukovićin që ishte mbrapa meje. Ai e ka thirrur Hasan Klapuh që të dalë nga vetura, unë kam qenë i ulur në veturë gjatë asaj kohe, sapo e ka nxjerrë nga vetura kam dëgjuar një të shtënë dhe kam vërejtur se Janko Janjiq po mbante armën në dorë. Nuk e di nëse njëri nga vëllezërit Kovaç apo Janjiq e kanë tërhequr zvarrë trupin e Klapuhit nëpër urë dhe e kanë hedhur nga ura, sepse unë isha ende në automjet. Feridën Klapuh njëri nga vëllezërit Kovaç, Milomir ose Radomir, e ka vlarë me pistoletë, jo, ka mundësi që e kanë vlarë me automatik, se e di që e kanë futur njërin në mjetin që patrulla nuk e ka gjetur. Dola nga automjeti dhe me urdhër të Janjiqit spërkata me rërë gjurmët e gjakut që vinin nga Hasani dhe Ferida. Vajza, Sena, bërtiti dhe iu lut që të mos e vrisnin dhe u drejtua drejt digës përmes tunelit, e ndjekur nga Zoran Simović dhe Zoran Vuković. Unë kalova pranë tyre me makinë, dhe në tunel u dëgjua një e shtënë dhe i pritja 150 metra larg urës...<sup>80</sup> Golubiqi shpjegoi në dëshminë e tij se pas gjithçkaje ata shkuan në një nga kafenetë lokale, por që nuk i komentuan vrasjet, sepse ishte një nga marrëveshjet e heshtura e njësisë "Dragan Nikolliq" të cilit i përkisnin.

Rëndësi të madhe ka edhe dëshmia e Marinko Dungjerskit, i cili ishte polic në detyrë në kalimin kufitar Shqepan Pole në atë ditë fatale. Dungjerski përshkroi sjelljen e të akuzuarve dhe të familjes Klapuh gjatë kalimit të kufirit, duke thënë se nuk ka vërejtur asgjë të pazakontë. Familja Klapuh i ka thënë se po strehohen në territorin e Malit të Zi për arsye sigurie. Kur kaluan kufirin rreth orës 12:30, Dungjerski i ka marrë automatikët me të cilët ishin të armatosur. Ajo që është e rëndësishme të theksohet në deklaratën e Dungjerskit është sjellja e Janjiqit dhe të tjerëve kur u kthyen në Foçë. Siç deklaroi Dungjerski: "...Të gjithë të akuzuarit u kthyen gjatë turnit tim, pra deri në orën 18:00. Para se të shkonin në Foçë, u ndalën në atë kafene. Në atë kafene ata kanë pirë shumë dhe kanë ngrënë darkë. Pas një kohe të akuzuarit janë nisur për në Foçë. Ata u ndalën pranë meje dhe unë, si zakonisht, u ktheva armët e tyre personale - automatikët. Ndërsa të akuzuarit ishin në kafënë, ku unë u ndalova dy-tri herë. Ata u sollën mjaft bukur. Ata pinë pak më shumë. Nuk vura re asgjë të pazakontë tek ata, madje bënin shaka. E di se gjithçka që të akuzuarit kanë ngrënë dhe pirë në atë tavernë atë mbrëmje, kur janë kthyer nga Pluzhina dhe Nikshiqi, është paguar nga Janjiq"<sup>81</sup>.

Për vrasjen e familjes Klapuh shkruan edhe Sheki Radonçiq, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar mizoritë e bëra ndaj familjes fatkeqe, si dhe mundimin që e ka bërë prej vitesh i vetmi pasardhës i mbijetuar i Hasanit - Feridi, i cili deklaroi: "Kam iniciuar procedurën përmes Komisionit të BeH për Kërkimin e Personave të Zhdukur që eshtrat e të dashurve të mi të zvarrosen dhe të transferohen në Bosnje. Dua që të gjitha të bëhen zyrtarisht dhe të regjistroheshin zyrtarisht".<sup>82</sup> Me gjithë përpjekjet e Feridit, eshtrat e familjes Klapuh gjenden ende në territorin e Malit të Zi, në zonën e komunës së Nikshiqit.

<sup>79</sup> Në periudhën para fillimit të luftës, Hasan Klapuh ka mbajtur postin e nënkryetarit të Komunës së Foçës..

<sup>80</sup> Kundër harresës, fq. 58-59.

<sup>81</sup> Njësoj, fq. 60-61.

<sup>82</sup> Liria Fatale: Deportimi i refugjatëve boshnjakë nga Mali i Zi, fq. 131.



➤ Varreza e përkohshme në Nikshiq ku u varros familja Klapuh<sup>83</sup>

Pavarësisht se aktgjykimi përfundimtar për këtë çështje është dhënë gati tridhjetë vjet më parë, asnjë nga katër të lartpërmendurit e dënuar me 20 vjet burg nuk ka marrë përgjegjësi për krimin e kryer. Dy autorët, përkatësisht Zoran Vuković dhe Radomir Kovaç, u dënuan për krime të kryera në territorin e komunës së Foçës në lëndën "FOÇA" (IT-96-23 dhe 23/1). Kovaç, si një nga zëvendëskomandantët e policisë ushtarake të Ushtrisë së Republikës Serbe dhe drejtues i forcave paraushtarake në qytetin e Foçës, u dënua me 20 vjet burg për skllavërim/robërim (krim kundër njerëzimit), përdhunim (krim kundër njerëzimit dhe shkeljen e ligjeve dhe zakoneve të luftës) dhe cenim të dinjitetit personal (shkelja e ligjeve dhe zakoneve të luftës). Vuković, i cili ishte gjithashtu një nga zëvendës komandantët e policisë ushtarake të Ushtrisë së Republikës Serbe dhe pjesëtar i forcave paraushtarake në qytetin e Foçës, u dënua me 12 vjet burg për torturë dhe përdhunim (krime kundër njerëzimit dhe shkeljen e ligjeve dhe zakoneve të luftës). Të dy u transferuan në Norvegji për të kryer dënimet e tyre, por Vuković u lirua para kohe në mars 2008, ndërsa Kovaç u lirua para kohe në 2013.<sup>84</sup>

Janjiq, përveç që ka kryer krimin ndaj familjes Klapuh, në aktakuzë për lëndën e përmendur "FOÇA" është përfshirë edhe si një nga zëvendëskomandantët e policisë ushtarake dhe udhëheqës i paraushtarakeve në Foçë.<sup>85</sup> Mirëpo, ashtu siç nuk ishte përgjegjës për krimet ndaj familjes Klapuh,

<sup>83</sup> Shkarkuar nga: <https://www.monitor.co.me/rtve-ratnog-zloina-rtve-i-poslije-smrti/>

<sup>84</sup> Informacionet për lëndën „FOÇA” (IT-96-23 i 23/1) Kunarac, Kovaç i Vuković. Në dispozicion në: [https://www.icty.org/x/cases/kunarac/cis/bcs/cis\\_kunarac\\_et\\_al\\_bcs.pdf](https://www.icty.org/x/cases/kunarac/cis/bcs/cis_kunarac_et_al_bcs.pdf). Akseluar me: 02.05.2024.

<sup>85</sup> Lënda Janković dhe të tjerë (IT-96-23/2) - aktakuza. Në dispozicion në: [https://www.icty.org/x/cases/kunarac/ind/bcs/foca-ii960626b.htm?fbclid=IwAR24\\_OtUR4shcOvByg1-d-ERR97NUgiVBFWO-iUPe2\\_aiQhgHj1CChXzc6U](https://www.icty.org/x/cases/kunarac/ind/bcs/foca-ii960626b.htm?fbclid=IwAR24_OtUR4shcOvByg1-d-ERR97NUgiVBFWO-iUPe2_aiQhgHj1CChXzc6U). Akseluar me: 03.05.2024.

Janjiq nuk u gjykua as para TPNJ-së, sepse në tetor 2000, gjatë operacionit të arrestimit të kryer kundër tij nga anëtarët e SFOR-it në Foçë, ai kreu vetëvrasje duke aktivizuar dy granata dore, ku vrau edhe dy anëtarë të SFOR-it.

Për fatin e Zoran Simoviqit, i cili ishte në arrati për dekada të tëra dihet shumë pak. Në bazë të informacioneve që Radio Evropa e Lirë ka marrë nga Gjykata Themelore në Foçë, Simoviqi ka ndërruar jetë në vitin 2020, ndërsa Vukoviqi dhe Kovaç kanë jetuar të lirë në atë qytet pavarësisht se shteti i Malit të Zi i kërkon për krim të kryer në vitin 1992. Mundësia për të përmbushur të paktën pjesërisht drejtësinë u humb në vitin 2015, kur Vukoviqi u arrestua nga policia serbe në kalimin kufitar të Kotromanit. Megjithatë, pasi kaloi një vit në paraburgim, Vukoviqi u lirua pavarësisht marrëveshjes së ekstradimit midis Serbisë dhe Malit të Zi.<sup>86</sup>

## Krimi në Shtërpçi

Krimi në Shtërpçi, përkundër faktit se nuk ka ndodhur në territorin e Malit të Zi, është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Nga 20 personat e vrarë në këtë krim, të paktën tetë ishin nga Mali i Zi. U vranë Esad Kapetanoviq, Ilijaz Liçina, Fehim Bakija, Sheqo Softiq, Rifat Husoviq, Halil Zupçeviq, Senad Gjeçeviq, Jusuf Rastoder, Ismet Babaçiq, Tomo Buzov, Adem Allomeroviq, Muhedin Haniq, Safet Prelleviq, Xhafer Topuzoviq, Rasim Qoriq, Fikret Memoviq, Fevzija Zekoviq, Nijazim Kajevisiq, Zvezdan Zulliçiq, dhe një person i panjohur.

Nga njëzet persona të rrëmbyer dhe të vrarë, deri më sot janë gjetur trupat e katër personave: Halil Zupçeviq, Rasim Qoriq, Jusuf Rastoder dhe Ilijaz Liçina. Të gjithë ata u gjetën në bregun e liqenit Peruqac më shumë se 15 vjet pas kryerjes së krimit. Kërkimi për trupat e viktimave të tjerë është ende në vazhdim.<sup>87</sup>

Ky krim i planifikuar dhe i ekzekutuar tërësisht u komandua nga Millan Llukiq<sup>88</sup>, udhëheqësi i njësisë paraushtarake në Vishegrad, i njohur si Hakmarrësit, për të cilin, do të rezultojë se ky ishte vetëm një nga një seri krimesh lufte që ai kreu në këtë zonë gjatë luftës. Në bazë të aktgjykimit para TPNJ-së, që u dha në lëndën “Vishegrad” (IT-98-32/1), Llukiq u dënua me burgim të përjetshëm për terrorin që kreu ndaj popullsisë myslimane në Vishegrad gjatë konfliktit në periudhën 1992-1995. Në vendim thuhej se Llukiq ishte dënuar për përndjekje mbi baza politike, racore dhe fetare, vrasje, akte çnjerëzore dhe shfarosje/zhdukje, si krime kundër njerëzimit, por edhe për vrasje dhe trajtim mizor, që ka shkelur ligjet dhe zakonet e luftës.<sup>89</sup>

<sup>86</sup> Milosh Rudoviq i Natalija Jovanoviq, „Rasti Klapuh: Si “harroi” Ministria e Drejtësisë e Serbisë të ekstradojë një kriminel lufte në Mal të Zi”, Radio Evropa e Lirë, Mars 2024. Në dispozicion në: <https://www.slobodnaevropa.org/a/crna-gora-slucaj-klapuh-ratni-zlocini/32861446.html>. Aksesuar me: 03.05.2024.

<sup>87</sup> Gjyqet për krime lufte në Mal të Zi (2009-2015), fq. 8.

<sup>88</sup> Në vitin 1994, Llukiq u arrestua në Beograd në vitin 1994 si i dyshuar për veprën penale të privimit të paligjshëm të lirisë së personave nga treni. Megjithatë, gjykata arriti në përfundimin se dëshmitë e dëshmitarëve nuk ishin të mjaftueshme për të konfirmuar kërkesat për hetim, kështu që Llukiq u transportua në Republikën Srpska.

<sup>89</sup> Informacione mbi lëndën „Vishegrad” (IT-98-32/1) Milan Llukiq i Sredoje Llukiq. Në dispozicion në: [https://www.icty.org/x/cases/milan\\_lukic\\_sredoje\\_lukic/cis/bcs/cis\\_lukic\\_lukic\\_bcs.pdf](https://www.icty.org/x/cases/milan_lukic_sredoje_lukic/cis/bcs/cis_lukic_lukic_bcs.pdf). Aksesuar me: 04.05.2024.

**Pasi u legjitimua nga njëri prej tyre, Içegiqi u informua se kishte një numër të caktuar dezertorësh dhe kontrabandistësh në trenin që po arrinte dhe se treni duhej të ndalohej. Kur deklaroi se duhej të informonte drejtorinë, ushtari që e legjitimoi vetëm i tha: “Ti je i imi nëse treni kalon”.**

Slobodan Içegiq, i cili në ditën fatale ishte dispeçer treni në stacionin e Shtërpçit, përshkroi atë që ndodhi para rrëmbimit në dëshminë e tij para Gjykatës së Lartë në Bijello Pole. Içegiqi ishte vetëm në stacion atë ditë, kur pas orës 15:00 hynë në zyrën e tij burra të armatosur, asnjëri prej të cilëve, sipas vlerësimit të tij, nuk ishte mbi 30 vjeç, me uniforma ushtarake dhe kamuflazhi, pa shenja. Pasi u legjitimua nga njëri prej tyre, Içegiqi u informua se kishte një numër të caktuar dezertorësh dhe kontrabandistësh në trenin që po arrinte dhe se treni duhej të ndalohej. Kur deklaroi se duhej të informonte drejtorinë, ushtari që e legjitimoi vetëm i tha: “Ti je i imi nëse treni kalon”. Më pas tregoi se si ndodhi rrëmbimi: “Menjëherë pas ndalimit pashë se ushtria po i nxirrte pasagjerët nga treni dhe po i çonte në drejtim të objektit ndihmës, d.m.th. ndërtesat për mirëmbajtjes së hekurudhave. Disa pasagjerë shkuan pa rezistencë, e disa rezistuan... Në mesin e atyre udhëtarëve njoha kolegun Fikret Memoviqin, i cili punoi me mua një kohë në Priboj dhe ishim të pandarë. Unë kisha një marrëdhënie të mirë me të, kështu që ai më ndihmoi të regjistroja fëmijën tim në auto shkollë. Fikreti më pa nga xhami dhe më thirri. E kuptova që thirrja e tij më drejtohej mua, për ta ndihmuar që të mos ta marrin. Atherë u përpoqa të largohesha nga dhoma e stacionit, por ushtarët që ishin në dhomë në atë moment nuk më lejuan ta bëja këtë. Meqë insistova që të mos e merrnin Fikretin, më thanë se do të më marrin edhe mua. Pastaj më shtynë në zyrë dhe nuk e pashë më Fikretin... Më vonë, në mesin e pasagjerëve të rrëmbyer, njoha edhe Sheqë Softiqin, të cilin e njihja që më parë, sepse ai punonte në “Zhegrap” si mbikqyrës. Sipas mendimit tim, u nxorrën nga treni rreth njëzet pasagjerë. Në mesin e pasagjerëve vura re një zezak, domethënë më shumë i ngjante një race të përzier, egjiptiane. Ai ishte i madh dhe mbante një xhakëtë në krah dhe një çantë. Nuk mbaj mend nëse pasagjerët e tjerë mbanin ndonjë gjë në duar. Kur shikova në drejtim të trenit në atë moment, pashë që nuk kishte pasagjerë në dritare dhe kishte një heshtje e rëndë...”<sup>90</sup>

Në dëshminë e tij, Içegiqi theksoi se kolegët e tij dhe ai vazhdimisht kanë insistuar që stacioni në Shtërpçe të sigurohet më mirë, sepse në turn ishte vetëm një punëtor, në një vend mjaft të shkretë dhe se për shkak të të shtënave që mund të dëgjoheshin në zonat përreth, shpesh i duhej të linte vendin e punës nga frika dhe të fshihej në errësirë. Fatkeqësisht, epurorët nuk iu përgjigjën këtyre apeleve të Içegiqit dhe kolegëve të tij.

<sup>90</sup> Kundër harresës, fq. 80-81.



**➤** Memorial për viktimat e rrëmbimit në Prijepole <sup>91</sup>

Nebojsa Ranisavleviq, i cili u dënua para Gjykatës së Lartë në Bijello Pole për pjesëmarrje në rrëmbimin dhe likuidimin e 19 qytetarëve të RF të Jugosllavisë, përshkroi në detaje se çfarë ndodhi atë ditë. Siç thuhet në vendim/aktgjykim, detajet e paraqitura nga Ranisavleviq ishin plotësisht të panjohura për policinë, prokurorin, gjykatësin dhe këdo tjetër. Prandaj, në bazë të dëshmisë së tij, u bë e mundur të rindërtohen ngjarjet e asaj dite. Përveçse përshkroi se si u bë pjesë e njësisë së Llukiqit, ai përshkroi edhe se si u krye krimi. Sipas Ranisavleviqit, i gjithë operacioni u menaxhua nga Millan Llukiq dhe Boban Ingjiq. Kur arritën në stacionin e Shtërpçit, Ranisavleviqi dhe të tjerët u ndanë në grupe më të vogla me detyra të qarta. Ranisavleviqi theksoi se asnjëri prej tyre as që u përpoq të fshihte fytyrat. Pas ndalimit të trenit, ata filluan me identifikimin dhe largimin e personave ekskluzivisht meshkuj.

*“...E gjithë kjo ngjarje ka zgjatur, nga momenti kur ka ardhur treni deri në momentin që treni ka dalë nga stacioni, 10-15 minuta. Të gjithë personat që u nxorrën nga treni u vendosën në trupin e kamionit për në kabinën. U urdhëruan të grumbulloheshin sa më shumë bashkë, madje u ulën në prehër të njëri-tjetrit... Sipas vlerësimit tim, në këtë mjet mallrash vendosëm gjithsej 19 persona, të cilët i nxorëm nga treni...”<sup>92</sup>, , tha Ranisavleviq.*

Pas kësaj, ata u nisën drejt Vishegradit dhe arritën në një nga fshatrat lokale, ku civilët e rrëmbyer u keqtrajtuan fizikisht dhe psikologjikisht, dhe më pas iu morën të gjitha sendet me vlerë. Prej aty kanë

<sup>91</sup> Foto Anadoluja, shkarkuar nga: <https://n1info.ba/regjia/a83994-godisnjica-otmice-u-strpcima/>

<sup>92</sup> Rrëmbimi në Shtërpçe – Analiza e gjyqimit për krime lufte: fakte, çështje juridike dhe implikimet politike, Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd 2003, fq. 67. Në dispozicion në: <https://www.hlc-rdc.org/images/stories/publikacije/Strpci.pdf>. Aksuar me: 05.05.2024.

vazhduar në një fshat tjetër, ku janë bërë likuidimet. Në deklaratën e tij Ranisavleviq më tej deklaroi: “Vetura është ndalur në një fshat, ku janë djegur të gjitha shtëpitë, kam vërejtur 4-5 shtëpia të djegura. Kamioni është ndalur rreth 5-6 metra larg një shtëpie të djegur në katin përdhësë të së cilës ka një garazh... Millani urdhëroi, dmth na dha një orar për të mbajtur sigurinë, na tha se nëse ndonjë nga ato njerëzit, të cilët i kapëm, u përpoqën të iknin, të qëllonim dhe të vrisnim... Ata njerëz që i kapëm, u hodhën nga kamioni në grupe prej 5-6 vetash. Ata njerëz u pranuan nga Millan Llukiqi dhe Boban Ingjiq... pas dëgjova urdhrin e parë... ‘shtrihu’. Pas asaj komande dëgjova të shtëna të heshtura... Dëgjova një të shtëne nga ana e majtë, u ktheva dhe pashë një person duke ikur. Menjëherë e hoqa pushkën nga supi dhe e qëllova atë person dhe ai person ra menjëherë, ndërsa ra e dëgjova të thoshte “mjerë nënë”. Në atë moment Millani doli nga garazhi dhe me zë të ngritur pyeti se kush e qëlloi... Unë iu përgjigja Millanit që qëllova dhe i tregova me gisht, pashë që Millani iu afrua dhe e goditi me bajonetë, pastaj Milani tha “kështu bëhet kjo punë”... Milani dhe Bobani i çuan të tjerët të rrëmbyerit të mbetur në garazh, pas një kohe të shkurtër u dëgjuan të shtëna, më pas Millani dhe Bobani dolën, na urdhëruan të hipnim në veturë... Millani nxori para dhe ora nga personat e robëruar, u shpërndau të gjithëve 100 DM dhe kush nuk kishte orë e fitoi një orë...”<sup>93</sup>

Një nga dëshmitarët e këtij krimi, Zoran Millikiq, në dëshminë e tij para Gjykatës së Lartë në Bijello Pole, deklaroi se më 27 shkurt 1993, pasi hipi në trenin numër 671 në Pozhegë, ai ndante vendin me Senad Gjeçeviq, një gjimnazist nga Tivari, të cilin e njihje më parë. “Kur arritëm në stacionin e Shtërpçit, pranë trenit në platformën e stacionit hekurudhor pashë disa ushtarakë me armë. Menjëherë pas ndalimit të trenit, nga vagoni i parë u nxorr një burrë në moshë të mesme, flokë gri, me xhup të kuq dhe këmbë të bardhë. Pranë atij personi ishte një ushtar dhe po ecnin në drejtim të stacionit hekurudhor... Menjëherë pas kësaj, një më i ri rreth 30 vjeç, me gjatësi mesatare, me uniformë kamuflazhi me beretë në kokë hyri në kupen tonë. Nuk vura re asnjë shenjë në uniformën e tij. Me vete kishte një automatik... Ai u përgjigj se mbiemri i tij ishte Gjeçeviq. Ushtarakët i kërkuan të tregonte emrin e tij, kështu që ai u përgjigj se quhej Senad. Pas kësaj, personeli ushtarak urdhëroi Senadin të dilte nga kupeja. Senadi nuk e kundërshtoi. Unë atëherë reagova dhe thashë: “Lëreni fëmijën, çfarë faji ka fëmija?”, sepse e kuptova se Senadin po e merrnin se është mysliman. Ata pastaj më janë përgjigjur: “Kush po të pyet ty, a do një plumb?”. Pas kësaj nuk bëra më pyetje...”<sup>94</sup>, ka thënë Millikiq në deklaratën e tij.

Radenko Grujiçiq, i cili gjithashtu dëshmoi para Gjykatës së Lartë në Bijello Pole, ishte drejtuesi i trenit atë ditë dhe përshkroi se si ndodhi rrëmbimi. Grujiçiq theksoi se treni në këtë linjë nuk ndaloi asnjëherë në stacionin e Shtërpçit, ndaj ishte detyrë e tij të dilte dhe të kontrollonte se çfarë po ndodhte: “Kur dola nga vagoni, vura re se pothuajse çdo vagon, nga njëra anë dhe nga ana tjetër gjendet nga një ushtar. Ushtari më i afërt m’u afrua menjëherë, thaç ditën e mirë dhe ai m’u përgjigj: “Zoti të ndihmoftë hero”. I njëjti ushtar ma vuri menjëherë pjesën e armës në gjoks dhe më kërkoi letër njoftimin. Ia dhashë. Teksa shikonte letrën e njoftimit, më pyeti se cilën festë e festoj. U tremba aq shumë sa nuk e mbaja mend festën time, por thashë “Krishtlindjen”. Pas kësaj, ushtari më ktheu letër njoftimin dhe më urdhëroi të hipja në tren...”, ka thënë në dëshminë e tij. Grujiçiq po ashtu ka deklaruar se nga frika nuk ka dalë nga kabina zyrtare, por pas 20 minutash kur më në fund ka nisur treni, pranë mjetit ushtarak ka vërejtur rreth 20 ushtarë me uniformë kamuflazhi. Grujiçiq ka vërejtur

<sup>93</sup> Njësoj, fq. 70-71.

<sup>94</sup> Kundër harresës, fq. 66-67.

gjithashtu se ushtarët ishin të armatosur me hekler, por nuk e ka parë momentin kur janë rrëmbyer pasagjerët, por për këtë e ka njoftuar gruaja e njërit prej pasagjerëve të rrëmbyer.<sup>95</sup>

Në shqyrtimin kryesor para Gjykatës së Lartë në Bijello Pole, Ranisavljeviq konfirmoi se ndër pasagjerët e rrëmbyer kishte një burrë me ngjyrë,<sup>96</sup> gjë që u konfirmua nga disa dëshmitarë të tjerë okularë, përfshirë oficerin Içegiq.

Ranisavljeviq u dënua me 15 vjet me aktgjykim të Gjykatës së Lartë në Bijello Pole, për shkak se ka kryer veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile dhe: *„...vullnetarisht ka pranuar të jetë pjesëtar i një grupi të armatosur dhe të vendoset nën komandën e Millan Llukiqit nga Vishegradi...”,* por edhe të kryejë në mënyrë të padiskutueshme të gjitha detyrat që i janë dhënë, që përfshinin ndalimin dhe largimin nga treni të personave me kombësi myslimane dhe kroate, pavarësisht se, si ish ushtar i APJ-së, ai ishte i vetëdijshëm se kjo paraqet shkelje të rëndë të së drejtës ndërkombëtare. Krahas kësaj Ranisavljeviq: *„...në fshatin Mushiq rojet po vëzhgojnë që të mos shpëtojnë asnjë nga personat e nxjerrë me forcë nga treni. Kur një person ka tentuar të arratiset, ai ka qëlluar menjëherë në drejtim të atij personi dhe kështu ka penguar arratisjen e tij. Ai person u godit dhe ra në tokë, të cilin më vonë iu afrua Milan Llukiq dhe u ther me bajonetë. Do të thotë se ai, si pjesëtar i një grupi të armatosur nën komandën e Millan Llukiqit nga Vishegradi, ka marrë pjesë në nxjerrjen e civilëve nga treni dhe më pas në vrasjen e atyre civilëve të pafajshëm. Nga gjithçka e paraqitur del se i akuzuari ka pasur dijeni për të gjitha elementet thelbësore të kësaj veprë penale dhe ka dashur ta kryejë atë, prandaj këtë vepër penale e ka kryer me dashje të drejtpërdrejtë...”<sup>97</sup>*

Për krimin në stacionin e Shtërpçit, në drejtësinë malazeze janë paraqitur një sërë çështjesh për kompensim të familjarëve të rrëmbyerve dhe të vrasësve, bazuar në paditë e ngritura kundër shtetit dhe në bazë të përgjegjësisë së organeve shtetërore për mbrojtjen të qytetarëve. Gjegjësisht, treni në linjën Beograd – Tivar është ndjekur nga patrulla policore, e cila nuk ka reaguar kur ka ndodhur rrëmbimi. Hulumtimi i Aksioni për të Drejtat e Njeriut tregon se shumata e akorduara ishin të pabarabarta, kështu që në raste të ndryshme nënave u shpërblyen me 15,000 € dhe 20,000 € për vdekjen e fëmijës së tyre. Po kështu, për vëllezërit e motrat, ai kompensim varionte nga 12,000 € në 15,000 €. Ajo që u konstatua gjithashtu në hulumtim është se këto shuma ishin dukshëm më të larta se shumata e dhëna për familjet e viktimave në Serbi.<sup>98</sup>

Një përparim i rëndësishëm, sa i përket këtij krimi, ka ndodhur në fund të vitit 2014, kur një operacion i përbashkët i policisë së BeH dhe Serbisë çoi në arrestimin e gjithsej 15 personave të dyshuar për këtë krim. Në vitin 2015, një proces gjyqësor kundër gjithsej 10 personave filloi në Gjykatën e BeH, njëri prej të cilëve, Miqo Joviçiq, anëtar i Brigadës së Vishegradit, pranoi fajin. Joviçiq u dënua ligjërisht me pesë vjet, ndërsa në procesin që pasoi, Obrad dhe Novak Polluga, Petko Ingjiq, Radojica Ristiçiq, Dragan

<sup>95</sup> Njësoj.

<sup>96</sup> Ranisavljeviq ka deklaruar se ky person ka folur gjuhën serbe dhe se ky person është rrahur më së paku nga të gjithë, por edhe se pa sukses ka tentuar t’ia blejë lirinë Llukiqit.

<sup>97</sup> Rrëmbimi në Shtërpçe - Analiza e gjyqësorit të krimeve të luftës: fakte, çështje juridike dhe implikime politike, fq. 332-333.

<sup>98</sup> Kompensimi për dëmet e viktimave të krimeve të luftës në Mal të Zi, fq. 26.

Shekariq, Oliver Krsmanović dhe Miodrag Mitrashinović, anëtarë të Brigadës së Vishegradit, u dënua me nga 13 vjet burg, dhe Boban Inxhiq, komandant i grupit Intervenes të Brigadës së Vishegradit, u dënua me 15 vjet burg. Procedura kundër Vuk Ratkoviçiqit, një tjetër pjesëtar i Brigadës së Vishegradit, u ndalua më 15 prill 2021 për shkak të vdekjes së të akuzuarit.<sup>99</sup>

Ndërkohë, më 10 maj në vitin 2018, Prokuroria për Krime Luftë në Serbi ka ngritur aktakuzë kundër gjithsej pesë personave për krimin në Shtërpçe. Për krimin në Shtërpçe u akuzuan anëtarët e njësisë “*Hakmarrësit*” Gojko Llukiq, Dushko Vasileviq, jubisha Vasileviq dhe Dragana Gjekiçiq, si dhe Jovan Llipovac, pjesëtarët e grupit të parë të batalionit të parë të brigadës së Vishegradit të Ushtrisë së Republikës Serbe.<sup>100</sup> Të akuzuarit, Gojko Llukiq, Dushko Vasileviq dhe Jovan Llipovac, u dënua me dhjetë vjet burgim me aktgjykim të shkallës së parë të datës 7 shkurt 2023, për rrëmbimin e pasagjerëve nga treni në Shtërpçe më 27 shkurt 1993 dhe abuzimin e tyre, torturën dhe vrasjet, dhe Dragan Gjekiçiq me pesë vjet burg, ndërsa i akuzuari Lubisha Vasileviq vdiq gjatë procedurës. Megjithatë, me vendim të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë është anuluar dhe lënda është kthyer në rigjykim.<sup>101</sup>

## Rasti Kallugjerski Ilaz

Gjatë bombardimeve të NATO-s në RF të Jugosllavisë, nga 24 mars 1999 deri më 10 qershor 1999, nga 80.000 deri në 100.000 refugjatë hynë në territorin e Republikës së Malit të Zi nga zona e Krahinës së atëhershme Autonome të Kosovës dhe Metohisë. Shumica e tyre hynë në Mal të Zi përmes kalimeve malore të pyllëzuara në komunën e Rozhajës dhe Plavës. Sipas zyrtarëve lokalë, deri në 8,000 njerëz hynin në Mal të Zi çdo ditë, mbi masivët malorë që ndajnë Malin e Zi dhe Kosovën.

Pretendimi se Mali i Zi u kujdes dhe i priti me ngrohtësi një numër kaq të madh të refugjatëve sipas deklaratave të qeverisë dikur republikane, tani shtetërore të Malit të Zi, si dhe të bashkësisë ndërkombëtare, luajti një rol vendimtar në sigurimin e reputacionit të Malit të Zi në luftën e Kosovës. Megjithatë, reputacioni i tillë i ndërtuar me mundim u kërcënua nga disa ngjarje në vetë kufirin.

Në përgjigje të fillimit të armiqësisë, njësitë e Korpusit të Podgoricës të Ushtrisë së Jugosllavisë u vendosën në zonën kufitare të komunës së Rozhajës. Supozohet se përleshjet mes Ushtrisë Jugosllave dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në zonën kufitare ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës kanë ndodhur që në vitin 1998, dhe u intensifikuan me fillimin e intervenimit të NATO-s.

<sup>99</sup> Krimet në Sanxhak në vitet 1990, Fondi për të Drejtën Humanitare. Në dispozicion në: <https://zonaneodgovornosti.net/digitalne-kolekcije/zlocini-u-sandzaku-devedesetih-godina/>. Aksesuar ne: 07.05.2024.

<sup>100</sup> Transkripti i regjistrimit audio nga shqyrtimi gjyqësor i mbajtur me 04. mars 2019. godine në lëndën K.Po2 br.4/2017. Në dispozicion në: <http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2019/09/02-04.03.2019..pdf>. Aksesuar me: 20.05.2024.

<sup>101</sup> Gjykata në Beograd e rrëzoi aktgjykimin e shkallës së parë për krimin në Shtërpçe, Radio Evropa e Lirë, dhjetor 2023. Në dispozicion në: <https://www.slobodnaevropa.org/a/zlocin-strpci-sud-presuda-ukinuta/32727362.html>. Aksesuar me: 20.05.2024.

Në kushte të tilla, kolonat e refugjatëve hynë në Mal të Zi përmes terreneve të paarrishme dhe të pyllëzuara, shpesh përgjatë shtigjeve malore. Mbetet ende e paqartë për atë që ndodhi në mars, prill dhe maj 1999. Dihet se pjesa më e madhe e refugjatëve hynë në Mal të Zi shëndoshë e mirë, por në disa raste Ushtria Jugosllave qëllon kolonat e refugjatëve në zonën e përgjegjësisë së Korpusit të Podgoricës dhe se ky aktivitet rezultoi me më shumë vdekje për një periudhë të gjatë kohore në zonën e gjerë kufitare të komunës së Rozhajës.<sup>102</sup>

Në aktakuzën e ngritur më 30 korrik 2008, Prokuroria Supreme e Shtetit ka theksuar se gjatë një ngjarje të tillë, më 18 prill 1999, janë vrarë gjashtë persona dhe pesë janë plagosur, dhe se në rastet e tjera që kanë ndodhur nga data 18 prill deri me 21 maj 1999, 11 persona të tjerë u vranë në disa lokacione. Të gjithë viktimat ishin të kombësisë shqiptare, mes tyre kishte edhe të mitur, gra dhe të moshuar. Prokuroria e cilësoi këtë si krim lufte dhe akuzoi tetë persona. I gjithë rasti do të emërohet sipas fshatit Kalugjerski Ilaz, ku ndodhi ngjarja më tragjike më 18 prill 1999, edhe pse jo të gjitha krimet janë kryer në atë vend, përfshirë edhe atë të kryer atë ditë.

Aktakuza kundër Predrag Strugarit, komandantit të Batalionit të Parë të Brigadës së Tretë të Këmbësorisë së Lehtë të Korpusit të Podgoricës dhe ushtarëve të tij vartës, u ngrit më 1 gusht 2008 dhe ata u akuzuan për shkeljen e rregullave të së drejtës ndërkombëtare dhe trajtim çnjerëzor ndaj civilëve. më 18 prill 1999 në Kallugjerski Ilaz popullatës me kombësi shqiptare, të cilët ikën nga konfliktet.<sup>103</sup>

Dëshminë e gjerë për ngjarjet e 18 prillit 1999 para Gjykatës së Lartë në Bijello Pole dha Brahim Lajiq, banor i Kallugjerski Ilaz, i cili takonte ushtarë çdo ditë rrugës për në punë në Rozhaje. Përveç kësaj, Lajiq thekson se ato ditë kolonat e refugjatëve nga Kosova kalonin nëpër zonë të papenguar dhe se nuk kishte probleme. Megjithatë, 18 prilli ishte ndryshe sepse ai dëgjoi të shtëna armësh nga shtëpia e tij, që vinin nga një urë aty pranë. Lajiq pa qartë se pesë persona u vranë, mes të cilëve një grua dhe dy u plagosën, duke përfshirë edhe djalin e tij, i cili mbijetoi dhe më vonë u trajtua në spital.

Në pjesën që ka të bëjë me vrasjen e civilëve, Lajiq ka deklaruar: *"...Një nga ata që vdiqën ra në ujë, dhe katër të tjerët ranë afër njëri-tjetrit. Ata vdiqën pranë urës në Crnjë. Duke qenë se ishte ditë, dukshmëria ishte e mirë dhe drejtimi ishte plotësisht i qartë. Të gjitha këto i pashë si në pëllëmbë të dorës, sepse kishte ende rreth një orë deri në një orë e gjysmë deri në mbrëmje. Pra, unë pashë gjithçka nga dritarja drejtë atij drejtimi. Kur filluan të shtënat, moti ishte pa reshje dhe dukshmëria ishte e mirë. Diçka më vonë, pasi pushuan të shtënat, filloi të bjerë borë dhe ra rreth 20 cm, dhe të nesërmen u shkri përsëri. Më kujtohet tani se si bora mbuloi trupat e të vdekurve duke u skuqur nga gjaku..."*<sup>104</sup>

Haxhi Ahmeti, nga një fshat afër Pejës, ishte duke lëvizur me familjen e tij në një grup prej rreth pesëdhjetë personash kur ata u ndalën në urën që Lajiq e përmendi në dëshminë e tij më 18 prill. Ahmeti është qëlluar në shpinë kur kanë filluar të shtënat. Të shtënat kanë zgjatur shumë dhe kur

më në fund janë ndalur, ai ka vërejtur rreth tij shumë të plagosur dhe të vdekur. I pyetur nëse ushtria ka tentuar t'u bëjë ndonjë paralajmërim, Ahmeti para gjykatës në Bijello Pole ka deklaruar: *"...Nuk kam dëgjuar asnjë britmë, madje as thirrjen "ndal" para se të fillonin të shtënat. Nuk i dëgjova as të shtënat derisa rashë. Aty gjendet ky përrua që shushuritej shumë..."* Atë natë ai dhe të mbijetuarit e tjerë u përpoqën të strehoheshin në njërin prej shtëpive, por shumë nga banorët e asaj zone, nga frika për jetën e tyre, thanë se nuk mund t'i prisnin. Në fund, ata arritën të vendosen në një nga shtëpitë ku kishte nga 20 deri në 30 persona. Ahmeti më pas u vendos në një spital në Berane, ku u mor në pyetje nga policia dhe përfundimisht u kthye në Pejë në fund të qershorit.<sup>105</sup>

Shemso Dedeiq, i cili në prill të vitit 1999 ishte shef i Departamentit të Sigurisë (OB) në Rozhaje, më 18 prill vendosi një grup oficerësh policie në fshatrat përreth Rozhajës, duke përfshirë Kallugjerski Ilaz, sepse vuri re një prani ushtarake në rritje. Oficerët e policisë e njoftuan atë, përmes radiolidhjes, se në Kallugjerski Ilaz kishte pasur të shtëna të mëdha dhe se kishte shumë të vdekur. Dedeiq, bazuar në njohuritë e tij personale dhe raportet e punonjësve të policisë nga terreni, ka bërë një listë të personave që kanë vdekur në zonën e komunës së Rozhajës gjatë kësaj periudhe. Kështu, sipas shënimeve që ka bërë, Dedeiq thotë se Sokol Lajiq dhe Tona Husaj janë vrarë në vendin Pas Hajle më 18 prill, ndërsa Milazim Pelaj, Rexhep Brahimaj, Sherif Brahimaj, Nemka Brahimaj, e linduri Demiq, Labinot Kastrati, Ramiz Brahimaj janë vrarë në Kallugjerski Ilaz. Më tej ai deklaroi se Selim Kelmendi dhe Afrim Djuraj janë vrarë nga një njësi e përbashkët ushtarako-policore, e cila ka ardhur nga drejtimi i Pejës më 18 prill 1999, në drejtim të fshatit Bukeli i Epërm, ndërsa në fushën Gilev, Faruk Murati dhe Arif Arifaj u vranë në maj të atij vit. Dedeiq thekson gjithashtu se më 21 maj 1999, në Balotiqi, trupat e vëllezërve Mehmed, Hetem dhe Ajet Rexhaj u masakruan dhe më pas u dogjën. Rexhaj Musa dhe Ramqaj Sadik u vranë pasi u torturuan. Gjatë, por edhe pas këtyre ngjarjeve, policia nuk ka mundur të kryej hetimin, pasi siç ka deklaruar mund të rrezikonte konflikt me ushtrinë. Dedeiq ka theksuar se refugjatët e ardhur nga drejtimi i Kosovës, sipas njohurive të tij, nuk kanë qenë të armatosur.<sup>106</sup>

Vendimi i Gjykatës së Apelit konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës së Lartë në Bijello Pole, duke i liruar të akuzuarit Predrag Strugar, Momçilo Barjaktarović, Petar Llabudović, Aco Knezhević, Branislav Radnić, Boro Novaković, Miro Bojović dhe Radomir Gjurashković, se kanë kryer veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile.<sup>107</sup>

Në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit thuhet se nuk ka asnjë provë që vërteton qartë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale, sepse në lokacionin Kallugjerski Ilaz, siç thuhet: *"...në vendngjarje kanë qenë jo më pak se 30 ushtarë dhe se aty nuk është një provë që do të nxirrte përfundimin se të akuzuarit janë ata që kanë gjuajtur predha artilerie që kanë vrarë dhe plagosur persona..."* Gjithashtu, gjykata thekson se ka mbetur e paqartë se përse akuza për veprën është ngritur ndaj të akuzuarit, kur personat e mbetur nga ajo skuadër ose njëri prej tyre mund të akuzoheshin me të njëjtën forcë dhe probabilitet provues. Më në fund, gjykata nuk vërtetoi se Strugari urdhëroi këtë togë ushtarësh të hapte zjarr ndaj civilëve të paarmatosur dhe as që të akuzuarit e tjerë të vepronin në përputhje me rrethanat.<sup>108</sup>

<sup>105</sup> Njësoj.

<sup>106</sup> Njësoj, fq. 138-148.

<sup>107</sup> Rasti „Kallugjerski Ilaz,” fq. 188.

<sup>108</sup> Njësoj, fq. 196-197.

<sup>102</sup> Procesi i ballafaqimit me të kaluarën në Mal të Zi - Rasti "Kallugjerski Ilaz", Qendra për Arsimit Qytetar, Podgoricë, 2019, fq. 6. Në dispozicion në: <https://media.cgo-cce.org/2019/11/Kallugjerski-ilaz-publikacija.pdf>

<sup>103</sup> Gjyqet për krime lufte në Mal të Zi (2009-2015), fq. 36.

<sup>104</sup> Kundër harresës, fq. 113-114.



➤ Nga përkujtimi i 25 vjetëve nga krimi i luftës në Kallugjerski Ilaz, organizuar nga Haxhi Lajci dhe avokati Vëlia Muriq<sup>109</sup>

Dhe në lëndën Kallugjerski Ilaz, janë iniciuar një sërë rastesh për kompensimin e dëmeve të viktimave dhe familjeve të tyre, në të cilat Ushtria e RFJ-së është caktuar si autore e krimit, ndërsa MPB-ja e Republikës së Malit të Zi ka qenë përgjegjëse për mbrojtjen e civilëve dhe pronës së tyre. Mirëpo, për shkak të parashkrimit të lëndës, padive të refuzuara dhe lëshimeve të ndryshme ligjore, kompensimi i viktimave para drejtësisë malazeze ka munguar. Përgjatë bën aktgjykimi sipas të cilit të plagosurit Haxhi Ahmeti i është caktuar shuma prej 12.000 €.<sup>110</sup>

Kallugjerski Ilaz është edhe një rast që rëndon jo vetëm komunitetin lokal dhe marrëdhëniet rajonale, por edhe kujtimin e momenteve të rëndësishme kur Mali i Zi priti një numër të madh refugjatësh. Prandaj, rrethanat në të cilat ndodhi vdekja e refugjatëve që kërkuan shpëtim në Mal të Zi duhet të sqarohen plotësisht dhe të ruhet kujtimi i ngjarjes.

## Rasti Zmajeviq

Pas më shumë se një dekade të marrëdhënieve të tensionuara ndëretnike, dhuna shpërtheu në Kosovë në vitin 1998, pasi UÇK-ja hyri në konflikt të hapur me autoritetet serbe. Beogradi u përgjigj

<sup>109</sup> Foto: Qendra për Arsimit Qytetar (QAQ)

<sup>110</sup> Kompensimi për dëmet e viktimave të krimeve të luftës në Mal të Zi, fq. 27-28.

duke dërguar përforsime policore dhe ushtarake për të shuar rebelimin.

TPNJ thekson se pjesëtarët e policisë dhe ushtrisë masivisht shënjestruan civilët, duke bombarduar fshatra dhe duke i detyruar shqiptarët e Kosovës të largohen. Pasi përpjekja për të arritur një marrëveshje për zgjidhjen e krizës me ndërmjetësimin ndërkombëtar përfundoi pa sukses gjatë bisedimeve të paqës në Rambujejë në fillim të vitit 1999, NATO filloi një fushatë 78-ditore të sulmeve ajrore kundër objektivave në Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi.<sup>111</sup> Pjesëtarë të forcave ushtarake dhe policore ishin edhe shtetasit/et e Malit të Zi.

Lënda kundër Vlado Zmajeviq, rezervist i Ushtrisë Jugosllave, është ngritur nga PSS për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile të kryera në territorin e Kosovës. Zmajeviq u akuzua për vrasjen e Imer Kadrijës në fshatin Dunav, e më pas në fshatin Zhegra (të dy në komunën e Gjilanit) dhe Qazim Hazirit, Mijazim Idrizit dhe Qamil Hazirit, të cilët ishin civilë të kombësisë shqiptare. Në aktakuzën e parë, Zmajeviq akuzohej për vrasjen e shtatë civilëve, por ky numër më vonë u reduktua në këta katër. Departamenti i Policisë Speciale, me urdhër të prokurorit special, ia ka hequr lirinë Vlado Zmajeviqit dhe më pas ka filluar gjykimin.<sup>112</sup>

Është interesante se krimet me të cilat është i lidhur Zmajeviqi janë diskutuar edhe para TPNJ-së shumë kohë përpara se PSS në Mal të Zi të ngrinte lëndën kundër tij, konkretisht në lëndën e Shainoviqit dhe të tjerëve (IT-05-87).<sup>113</sup> Përkatësisht, mbrojtësit e dy të akuzuarve në këtë rast, Nebojsa Pavkoviç, komandanti i Armatës së Tretë të UJ-së dhe Sreten Lukiç, kryetar i MPB-së së Republikës së Serbisë për Kosovë e Metohi, argumentuan se Zmajeviqi ka vepruar vetë, dhe se ishte Pavkoviç, në një verzion të tregimit, dhe Lukiç sipas versionit të dytë, janë eritor për faktin se Zmajeviq ishte ndjekur penalisht shumë më herët para një gjykate ushtarake në Jugosllavi dhe se u dënua me 20 vjet në burg.<sup>114</sup> Megjithatë, në aktgjykimin e Gjykatës së Lartë në Podgoricë nuk thuhet askund se Zmajeviqi ishte dënua për këto krime para se të ngrihej aktakuza kundër tij në shkurt të vitit 2017.

Një nga dëshmitarët në rastin kundër Zmajeviqit ishte Damir Noviq, i cili u takua me Zmajeviqin si vullnetar gjatë konfliktit në Kosovë. Sipas dëshmisë që Noviq ka dhënë para gjykatës në Beograd, ai ka qenë në veturë me të akuzuarin kur ky i urdhëroi djaloshit para të cilit kalonin të ndalet dhe më pas filloi ta ndjekë. Zmajeviq më pas u drejtua në një shtëpi ku vrau dy burra pa hezitur<sup>115</sup>, duke thënë: "A don të vras". Më pas është futur në shtëpi ku duke kërkuar djaloshin që ka ikur ka sulmuar gruan që ndodhej aty. Noviqi u përpoq ta largonte me fjalët: "Zmajeviq, çfarë po bën, hajde të ikim

<sup>111</sup> Më shumë në: <https://www.icty.org/bcs/o-mksj/sta-je-bivsa-jugoslavija/sukobi>

<sup>112</sup> Zbatimi i Strategjisë për Hetimin e Krimeve të Luftës të Prokurorisë së Shtetit të Malit të Zi (2015-2021), fq. 20-21.

<sup>113</sup> Të dhënat për rastin Shainoviq dhe të tjerët (IT-05-87). Në dispozicion në: [https://www.icty.org/x/cases/milutinovic/cis/bcs/cis\\_sainovic\\_et\\_al\\_bcs.pdf](https://www.icty.org/x/cases/milutinovic/cis/bcs/cis_sainovic_et_al_bcs.pdf). Aksesuar me: 15.05.2024.

<sup>114</sup> Kush është përgjegjës për vrasësit e shqiptarëve të Kosovës, SENSE - Qendra për Drejtësi Tranzicionale, Hag, shkurt 2008. Në dispozicion në: <https://arhiva.sensecenter.org/vijesti.php?aid=5347>. Aksesuar me: 16.05.2024.

<sup>115</sup> Gjykata në Podgoricë konstatoi se dy personat e vrarë nga Zmajeviqi ishin Qazim Haziri dhe Milazim Idrizi.

nga këtu”, për të cilën ky iu përgjigj: “po tani, vetëm të vras gjyshen”. Pasi ka thënë: “Dil që ta vras”, dhe ka qëlluar gruan me automatik.<sup>116</sup> Edhe pas krimit të kryer, Zmajeviq ka vazhduar sjelljen e tij të dhunshme ndaj ushtarit të njësisë së tij, por edhe në mënyrën se si ka qëlluar bagëtinë në fshatin Zhegra. Dëshmitari zbuloi se Zmajeviq kishte vrarë më parë një bari, por në fund ai u arrestua nga policia.<sup>117</sup>

Zmajeviq në dëshminë e tij ka thënë se dy burrat, të cilët Noviqi i ka përmendur në dëshminë e tij, i ka vrarë për shkak se kishte frikë për jetën e tij, dhe se nuk shihte nëse ishin të armatosur, ndërsa gruan e vrau sepse ajo e pështyu dhe e shau pavarësisht se ishte me uniformë ushtarake, gjë që e konsideroi si fyerje personale. Ai gjithashtu deklaroi se procesi ndaj tij ishte i montuar dhe se shërbente për të mbuluar vrasjet e civilëve të kryera nga policia në fshatin Zhegra.<sup>118</sup>

Për vrasjen e bariut të përmendur, i cili quhej Imer Kadriu, ishte dëshmitar një vullnetar tjetër – Danijel Çoliq, i cili tregoi se si është kryer ky krim. Siç ka deklaruar, Zmajeviq e ka detyruar shoferin e kamionit në të cilin Çoliqi gjendej të nisej në drejtim të fshatit Zhegra, por edhe ka urdhëruar kamionin të ndalet në një vend, ku në anë të rrugës ka vërejtur bariun e moshuar. Më pas, pasi ka zbritur nga kamioni, Zmajeviq e ka pyetur bariun se kush ishte dhe ku po shkonte, por kur bariu u përgjigj në shqip, Zmajeviqi e qëlloi me automatik dhe e vrau me tre plumba. Në pyetjen e Çoliqit pse e vrau, Zmajeviq vetëm u përgjigj: “Sepse është Shiptar”.<sup>119</sup> Kufomën e fatkeqit Imer Kadriut e ka gjetur djali i tij Armenti, i cili ka dëgjuar të shtënat dhe ka parë një kamion që lëvizte jo shumë larg shtëpisë së tyre, në të cilin ndodhej Zmajeviqi.



➔ Fotografitë e viktimave - Milazim Idrizi, Qazim Haziri i Qamila Haziri<sup>120</sup>

<sup>116</sup> Zmajeviq, siç konstatoi gjykata, ka vrarë 55-vjeçaren Qamile Haziri, gruan e të vrarit Qazim.

<sup>117</sup> Kundër harresës, fq. 156-158.

<sup>118</sup> Njësoj.

<sup>119</sup> Njësoj.

<sup>120</sup> Shkarkuar nga: <https://2lonline.com/muhadin-haziri-rrefen-tmerrin-e-marsit-te-vitit-1999-qe-ndodhi-ne-zheger/>

Zmajeviq u dënua në Gjykatën e Lartë në Podgoricë më 5 maj 2019 me katërbëdhjetë vjet burgim, ku përfshihej koha e privimit të lirisë dhe koha e qëndrimit në paraburgim duke filluar nga 4 gushti 2016. Sipas aktgjykimit, Zmajeviq u dënua për shkak se, si pjesëtar i Ushtrisë Jugosllave, më 30 mars 1999, në zonën e fshatrave Zhegra dhe Dunav të komunës së Gjilanit, AP Kosovë dhe Metohi, gjatë konfliktit të armatosur ndërmjet forcave të NATO-s dhe pjesëtarëve të UÇK-së nga njëra anë dhe RFJ-së nga ana tjetër, ka shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare dhe ka kryer vrasjen e katër civilëve të kombësisë shqiptare duke mos treguar humanizëm apo duke shmangur diskriminimin në bazë të kombësisë, fesë dhe besimit.<sup>121</sup>

Mbrojtësit e Zmajeviqit e apeluan vendimin e Gjykatës së Lartë, duke argumentuar se ishte e pavlefshme sepse bazohej në deklaratat e të akuzuarit të bëra para Gjykatës Hetues të Gjykatës Ushtarake në vitin 1999, në të cilat ai pranoi vrasjen e tre civilëve shqiptarë. Avokatët mbrojtës argumentuan se ato deklaratat janë bërë në kuadër të krimeve pronësore dhe se ato nuk mund të përdoren si provë. Gjykata e Apelit deklaroi se riklasifikimi i veprës penale në një fazë të mëvonshme të procedurës nuk përjashton përdorimin e deklaratave të mëparshme, sepse bëhet fjalë për të njëjtat ngjarje, ndaj me vendim të Gjykatës së Apelit të datës 18.11.2019 ankimi u refuzua si i pabazuar dhe u vërtetua dënimi me burg prej katërbëdhjetë vjetësh.<sup>122</sup>

Në këtë mënyrë rasti kundër të akuzuarit Zmajeviq paraqet një nga rastet e rralla në territorin e Malit të Zi në të cilin është dhënë dënimi për krime lufte. Kjo lëndë është e rëndësishme edhe për gjyqësorin malazet sepse tregon se procese të tilla mund të përfundojnë kur ka punë të përkushtuar profesionale të prokurorisë dhe gjykatave, por thekson edhe rëndësinë e drejtësisë dhe përgjegjësisë për krimet e kryera.

<sup>121</sup> Aktgjykimi i Gjykatës së Lartë në Podgoricë për lëndën Ks. nr. 2/2017.

<sup>122</sup> Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit për lëndën Kzh-S 14/2019.



# Rekomandime për mësuesit/et

Temat mësimore që lidhen me të kaluarën e afërt zakonisht perceptohen nga mësuesit/et si tema komplekse, të cilat janë edhe më të vështirat për t'u mësuar. Kjo konfirmohet nga hulumtimi i publikuar në vitin 2017 nga EUROCLIO (Shoqata Evropiane e Mësuesve të Historisë), ku janë përfshirë mësuesit/et nga Ballkani Perëndimor. Gjegjësisht, hulumtimi, i cili është bërë përmes intervistave me mësuesit/et, çon në përfundim se mësuesit/et nga Mali i Zi (por edhe nga Serbia dhe BeH) e kanë më të vështirë të ligjërojnë tema që kanë të bëjnë me luftërat e viteve 1990. Në hulumtim u arrit përfundimi se kurrikulat në këto shtete përmbajnë këtë temë, por nuk rekomandojnë trajtimin e kontroverzave që dalin prej saj.<sup>123</sup>

Nga ana tjetër, një numër i madh i mësuesve/eve nga Mali i Zi në dhjetë vitet e fundit kanë pasur mundësinë të ndjekin një sërë seminaresh, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, të cilat u dhanë mundësi të zgjerojnë njohuritë dhe kompetencat e tyre. Këto edukime më së shpeshti kanë qenë pjesë e projekteve dhe iniciativave në të cilat ka marrë pjesë Shoqata e Profesorëve të Historisë të Malit të Zi (HIPMONT). Megjithatë, që në fillim ishte e qartë se edhe mësuesit/et që duan të merren me këtë temë kanë një sërë pengesash, të cilat do t'i renditim më poshtë dhe të cilat ne u përpoqëm t'i tejkalojmë së bashku me ta.

Sfida kryesore, e cila është e pranishme edhe sot, është në faktin se kjo temë, e cila përfaqësohet në mënyrë dominuese në orët e historisë, mësohet në klasat e fundit të shkollës fillore dhe të mesme. Gjithashtu, sipas planit dhe programit, këto tema paraqiten në fund të ciklit të fundit të klasifikimit. Pavarësisht se këtu ka një argument të vlefshëm për mungesën e mundshme të kohës, mësuesit/et duhet të jenë të vetëdijshëm për faktin se në serinë e reformave që ka kaluar sistemi ynë arsimor në dekadat e fundit, më në fund ka mundësi për ti inkuorporuar këto tema në mënyra të ndryshme. Situata në shkollat e mesme profesionale është edhe më specifike, sepse nxënësit e mësojnë historinë si lëndë gjatë një viti shkollor dhe plani dhe programi parashikon që gjatë të njëjtit të përpunohen proceset historike nga mesjeta deri në fillim të shekullit XXI.<sup>124</sup>

<sup>123</sup> Maric, D., & Jovanović, R. *Teachers On Teaching: How Practitioners See The Current State And Future Developments In History Education Across The Western Balkans (Rep.)*, EUROCLIO, Hague, The Netherlands 2017. Në dispozicion në <https://euroclio.eu/wp-content/uploads/2018/10/ePact-MNE.pdf>. Aksesuar me: 05.05.2024.

<sup>124</sup> *Programi lëndor Historia për klasën I ose II të shkollës profesionale*, Instituti i Arsimit, Podgoricë 2017. Në dispozicion në: <https://www.gov.me/dokumenta/32540725-aaed-4b81-a9b4-75683e6e6ff0>. Aksesuar me: 19.05.2024.

Për të dhënë një rekomandim më të qartë këtu, do t'i referohemi një shembulli praktik nga ky doracak. Gjegjësisht, një nga rastet që është proceduar është rasti i deportimit të refugjatëve nga Mali i Zi. Me shpresën se materiali i ofruar këtu do të jetë i dobishëm për mësuesit/et që t'u shpjegojnë nxënësve/eve në çfarë mënyre dhe pse refugjatët nga BeH u deportuan nga Mali i Zi më shumë se tridhjetë vjet më parë, ne duhet të shqyrtojmë nëse, në kuptimin tematik, mund të bëhet një lidhje me një njësi tjetër mësimore. Natyrisht, si shembull logjik mund të përdoren një sërë deportimesh të ndodhura gjatë Luftës së Dytë Botërore, me shënimin se mësuesi/ja ka autonominë për të zgjedhur shembujt që ai/ajo i konsideron më relevant.

Edhe migrimet e detyruara që i paraprinë krimeve në Kallugjerski Ilaz dhe vrasjes së familjes Klapuh mund të jenë pjesë e një tërësie të përbashkët për llojet dhe arsyet e migrimit, si dhe pasojat e tyre për shoqërinë. Në të njëjtën mënyrë, gjatë përpunimit të rastit të kampit Morinj, mësuesit/et mund të bëjnë një paralele me ekzistencën e kampeve të tjera në atë periudhë në territorin e ish-Jugosllavisë, por edhe me kampet në periudha të tjera historike.

Pra, mundësi dhe shembuj ka shumë, thjesht duhet të përdoren në mënyrën e duhur.

Sigurisht, këtyre mësuesve/eve u jepet edhe një sugjerim i përgjithshëm që të përpiqen sa më shumë të largohen nga qasja e vjetëruar kronologjike e studimit të Historisë dhe të krijojnë një koncept tematik, dukshëm më kuptimplotë dhe më të dobishëm për nxënësit. Frika se në këtë mënyrë një pjesë e caktuar e kurrikulës nuk do të kalohet është e pabazë, sepse me këtë qasje fokusi është në proceset, dhe jo në memorizimin e thjeshtë të të dhënave historike.

Një tjetër pengesë jo më pak e rëndësishme lidhet me perceptimin e “të tjerëve” në mësimdhënien e historisë. Ky problem në përgjithësi lidhet me mësimin e historisë, por është veçanërisht i theksuar kur flasim për tema historike të ndjeshme dhe kontroverze. Narrativat që krijohen, të cilat shpesh paraqiten në tekste shkollore, çojnë në krijimin e viktimizimit kolektiv dhe/ose fajit kolektiv dhe shpesh ngjarje të caktuara heshten në mënyrë të ndjeshme ose përmenden vetëm faktikisht, pa kontekstualizim.

Në fund, diçka që është e dukshme tek të gjithë mësuesit/et është mungesa e arsimit formal kur bëhet fjalë për luftërat e viteve 1990. Pavarësisht se gjatë punës sonë në këto tema kemi takuar shumë mësues/eve të cilët kanë entuziazmin, dëshirën dhe, ndoshta më e rëndësishmja, nevojën profesionale për të dhënë mësim për këto tema - fakti që asnjëri prej tyre nuk kishte mundësi gjatë studimeve të historisë të mësojnë më shumë për luftërat, ishte një pengesë e përbashkët. Kjo shkaktoi një shkallë të pasigurisë, sepse disa prej tyre, për një arsye, nuk ndiheshin mjaft të përgatitur për të përpunuar në mënyrë adekuate njësinë mësimore që kanë të bëjnë me luftërat e viteve '90 të shekullit të kaluar.

Të vetëdijshëm për këto, si dhe për shumë mangësi të tjera, disa mësues/se të historisë nga Mali i Zi, por edhe nga i gjithë rajoni, filluan punën intensive në vitin 2016, e cila rezultoi në zhvillimin e metodave cilësore të mësimdhënies për mësim të përgjegjshme të së kaluarës së afërt. Një nga rezultatet e punës së përbashkët të mësuesve/eve të historisë nga rajoni janë rekomandimet për

mësimdhënie të përgjegjshme të luftërave të viteve '90, të cilat u krijuan në kuadër të projektit "Mësimi i historisë që nuk është ende"<sup>125</sup>. Në kuadër të këtyre rekomandimeve thuhet qartë se synimet mësimore të këtyre luftërave duhet të vendosen në përputhje me qëllimin e ndërtimit të paqes së qëndrueshme. Përveç kësaj, mësuesit/et duhet të lënë mënjanë të gjitha qëndrimet personale, shpesh emocionale, dhe t'u përmbahen normave profesionale. Për këtë arsye është e nevojshme që mësuesit/et të marrin njohuri faktike rreth lëndës, por edhe të kuptojnë kompleksitetin e së kaluarës dhe interpretimet e saj, si dhe mënyrat në të cilat historia shpesh keqpërdoret për hir të ideologjive, besimeve dhe interesave të ndryshme.<sup>126</sup>

Këto rekomandime janë një hap i parë për mësuesit/et që duan të studiojnë dhe japin mësim në këtë temë, dhe një burim i vlefshëm nëse qëllimi është mësimdhënie e përgjegjshme në histori. Mirëpo, siç thuhet në këto rekomandime, është e nevojshme që mësimdhënësit të marrin njohuri faktike rreth kësaj teme dhe një nga pengesat është mungesa e edukimit formal për këto çështje. Nëse i shtojmë edhe etnocentrizmin e kurrikulës dhe teksteve shkollore, bëhet më e qartë pse është e domosdoshme të merren njohuri objektive dhe të dobishme për të gjithë procesin.

Puna në këtë doracak, i cili kryesisht bazohet në vendimet për krimet e luftës para gjyqësorit malazez, bazohet edhe në përvojën e fituar nga autorët gjatë viteve të bashkëpunimit me Mekanizmin Ndërkombëtar Rezidual për Gjykatat Penale (Mekanizmi)<sup>127</sup>. Si pjesë e këtij bashkëpunimi, u hap mundësia për t'u njohur me arkivin e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) dhe mënyra se si ai arkiv mund të përdoret në mësimdhënien e përgjegjshme të historisë së luftërave të viteve 1990. Një numër i madh i mësuesve/eve të historisë, si dhe të lëndëve përkatëse, nga Mali i Zi patën mundësinë të mësojnë për arkivin dhe mënyrat e përdorimit të tij përmes një sërë seminaresh dhe edukimesh të tjera.<sup>128</sup>

Përmirësimi i vazhdueshëm i një pjese të mësuesve/eve, e shpeshherë edhe iniciativa e tyre personale, ka bërë që këto tema të bëhen pjesë e interesit të tyre të ngushtë, me të cilin ata mund të merren me përgjegjësi profesionale. Këtë e tregon edhe fakti se qysh në vitin 2022, në edicionin e QAQ u botuan pesëmbëdhjetë punëtori<sup>129</sup> me temën e mësimi të historisë së kontroverse të luftërave në vitet '90. Në të kanë punuar 15 pedagogë/e nga Mali i Zi, të cilët tentuan të shpjegojnë temat kontroverse përmes prizmit të sportit, ekonomisë, kulturës, jetës së përditshme, por edhe përmes krimeve të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë. Duke qenë se ishte një sipërmarrje pioniere

<sup>125</sup> Më shumë për projektin në: <https://euroclio.eu/projects/learning-a-history-that-is-not-yet-history/>

<sup>126</sup> *Making sense of the past that refuses to pass - Recommendations for responsible teaching of the wars in Yugoslavia and its successor states*, Euroclio 2018, The Hague. Në dispozicion në: [https://euroclio.eu/wp-content/uploads/2016/12/Making-sense-of-the-past-that-refuses-to-pass\\_final-English.pdf](https://euroclio.eu/wp-content/uploads/2016/12/Making-sense-of-the-past-that-refuses-to-pass_final-English.pdf). Aksesuar me: 10.05.2024.

<sup>127</sup> Më shumë rreth Mekanizmit Ndërkombëtar Rezidual për Gjykatat Penale në: <https://www.irmct.org/bcs>

<sup>128</sup> *MIP vazhdon me seminare për mësues të historisë nga Mali i Zi*, IRMCT, dhjetor 2021. Në dispozicion në: <https://www.irmct.org/bcs/novosti/mip-nastavlja-sa-radionicama-za-nastavnike-istorije-iz-crne-gore>. Aksesuar me: 20.05.2024.

<sup>129</sup> *Mësimdhënia e historisë për arsim të përgjegjshëm - 15 punëtori*, Qendra për Arsimit Qytetar, Podgoricë 2022. Në dispozicion në: <https://media.cgo-cce.org/2022/03/Nastava-kontroverzne-istorije-radionice.pdf>. Aksesuar me: 18.05.2024.

në këtë fushë në Mal të Zi, ky doracak mund të ndihmojë në punën e mëtejshme.

Bazuar në përvojën e përdorimit të arkivave të Mekanizmit dhe TPNJ-së, u arrit në përfundimin se mësuesit/et mund të aplikojnë metodën e mësimdhënies për mirëkuptim gjatë studimit të luftërave të viteve '90. Kjo metodë mbështetet në qasje që thekson atë që është interesante dhe e rëndësishme për ta. Edhe pse mësuesit/et kanë dhe duhet të kenë lirinë për të përcaktuar aspektet më të rëndësishme që duan t'u përcjellin nxënësve/eve të tyre, kjo liri është veçanërisht e rëndësishme në shoqëritë pas konfliktit. Përdorimi i kësaj metode i lejon stafit mësimdhënës të përqendrojë mësimdhënien në tema kyçe, gjë që ndihmon më tej gjeneratat e reja të kuptojnë më mirë kompleksitetin dhe rëndësinë e ngjarjeve historike, duke kontribuar kështu në një kuptim më të thellë dhe ndërtimin e paqes së qëndrueshme.<sup>130</sup>

Mësuesit gjithashtu, gjatë studimit të këtyre temave, mund të përdorin raportin e përmendur tashmë nga Mauricijo Salustros si një shembull konkret se si t'i të ja bëjnë më të qartë nxënësve kompleksitetin e hulumtimit të krimeve të luftës dhe zbatimin e strategjive ligjore. Hulumtimi i Salustros ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi zbatimin e Strategjisë për Hetimin e Krimeve të Luftës të Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Malit të Zi në periudhën 2015-2021. Nëpërmjet analizës së atij raporti, mësuesit, si dhe nxënësit, mund të kuptojnë më mirë sfidat specifike me të cilat përballen autoritetet gjyqësore gjatë mbledhjes së provave, sigurimit të drejtësisë për viktimat dhe garantimit të një gjykimi të drejtë për të akuzuarit. Në raport gjithashtu theksohet rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar në procesin e gjyqësorit të krimeve të luftës, që mund të shërbejë si një nxitje për të kuptuar standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe zbatimin e tyre në sistemet ligjore kombëtare.

Si përfundim, pavarësisht numrit të pengesave me të cilat përballen mësuesit/et, mësimdhënia për luftërat e viteve '90 është një domosdoshmëri. Bazuar në përvojat e fituara në vitet e mëparshme, është e qartë se ekzistojnë mjete dhe metoda që lejojnë që kjo temë të përçohet në mënyrë efektive në klasa në Mal të Zi. Mësuesit/et përballen me sfida si mungesa e edukimit formal, ndjeshmëria e temës, interpretimet e ndryshme të ngjarjeve dhe reagimi emocional i nxënësve/eve, por kjo nuk e zbeh rëndësinë e edukimit për këtë periudhë. Duke përdorur një qasje të tillë si mësimdhënia për të kuptuar, e cila thekson aspektet relevante dhe interesante, mësuesit mund t'i kapërcejnë këto sfida. Këto mjete dhe metoda jo vetëm që lehtësojnë mësimin e kësaj teme komplekse, por gjithashtu ndihmojnë në zhvillimin e të menduarit kritik dhe të kuptuarit më të thellë mes nxënësve/eve. Nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit të kujdesshëm të këtyre strategjive, mundësohet integrimi i suksesshëm i mësimdhënies për luftërat e viteve '90 në kurrikulë.

<sup>130</sup> *Doracak për edukatorët e historisë/historisë/historisë mbi përdorimin e arkivave të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe Mekanizmin Ndërkombëtar Rezidual për Gjykatat Penale, Programi i Mekanizmit Informativ (PMI)*, Hagë 2023. Në dispozicion në: <https://www.irmct.org/sites/default/files/publications/Handbook%20History%20Teachers-Vol%20I-BCS.pdf>. Aksesuar me: 13.05.2024.

# Rishikimi

Përdorimi i të kaluarës për të legjitimuar të tashmen është imanent në të gjitha shoqëritë. Në komunitetet me një përvojë të theksuar romantike të së kaluarës, ai proces është më kompleks, sepse e kaluara përdoret si një platformë për veprim politik bashkëkohor, në të cilin afirmohen dhe mbështetën vetëm idetë që kanë “bazë historike”. Mali i Zi është padyshim një shoqëri me nevojë të theksuar dhe për të përdorur të kaluarën. Duke iu referuar “*të kaluarës së lavdishme dhe heroike*”, duan të legjitimojnë forma të ndryshme të veprimit politik dhe shoqëror, ndaj interpretimet e shëmtuara dhe të padëshiruara pothuajse përjashtohen në një interpretim të tillë.

Ky lloj qëndrimi i shoqërisë malazeze ndaj së kaluarës është një nga arsyet kryesore pse ballafaqimi me pjesët e vështira dhe jo të njohura të historisë është një sfidë me të cilën përballet çdo gjeneratë. Nuk duhet të përkujtojmë në rastin e akademikut Branimir Gjurgjev, i cili në fillim të viteve 50 të shekullit të XX nuk mundi të botojë libërin në Akademinë Serbe të Shkencave dhe Arteve (SANU), sepse konfirmoi tezën për sundimin osman në Mal të Zi në shekujt XVI dhe XVII bazuar në materialet dhe dokumentet arkivore dhe rrëzoi “*të vërtetën tradicionale historike*” se Mali i Zi nuk ishte kurrë nën sundimin osman. Në paraqitjen romantike malazeze të së kaluarës, ka shumë shembuj të ngjashëm të interpretimit joshkencor të proceseve historik.

Nga ana tjetër, kishte pjesë të vështira të së kaluarës malazeze që për shkak të bollëkut të burimeve historike, thjesht nuk ishte e mundur të interpretoheshin në mënyrë kreative. Si rregull, tema të tilla liheshin jashtë dhe për to kishte një marrëveshje të heshtur “*se është ende herët për të folur*”. Në grupin e këtyre temave përfshihet padyshim qëndrimi i Malit të Zi ndaj luftërave të viteve ‘90, roli dhe sjellja e aktorëve kryesorë dhe së fundi, pasojat e veprimeve të tilla. Në komunitetin akademik, shpesh është pretenduar se nuk ekziston një “*distancë historike*” për të diskutuar në mënyrë përkatëse këto tema, megjithëse për historiografinë shkencore e vetmja gjë e rëndësishme është: nëse ka burime përkatëse për një çështje të caktuar historike apo jo.

Në këtë kontekst, doracaku „*Krimet e luftës të viteve 1990 në vendimet e gjyqësorit malazez*” paraqet një distancë nga tregimi historiografik tradicional në Mal të Zi. Në pesë kapituj (*Konteksti juridik ndërkombëtar; Mali i Zi dhe luftërat e viteve 1990 - konteksti historik; Luftërat e viteve 1990 në sistemin arsimor malazez; Krimet e luftës të viteve 1990 në vendimet e gjyqësorit malazez; Rekomandime për mësuesit(et)*) autorët e doracakut, Igor Radulović dhe Milosh Vukanović, ofrojnë një kornizë origjinale dhe funksionale për mësimin e historisë lidhur me ngjarjet e luftës të viteve ‘90, më saktë qëndrimin e shoqërisë malazeze ndaj shtatë rasteve të krimeve të luftës që morën epilog gjyqësor në Mal të Zi: *Kampi Morinj, Rasti Deportimi; Krimet në Bukovicë; Vrasja e familjes Klapuh; Krimi në Shtërpçi; Rasti Kallugjerski Ilaz; Rasti Zmajeviq.*

*Shkenca dhe praktika kanë treguar se në shoqëritë që nuk përballen siç duhet me të kaluarën e tyre, mundësia e ripërtëritjes së konflikteve rritet në mënyrë dramatike. Si pasojë, në epokën moderne në të cilën jetojmë, “ballafaqimi” me tema të caktuara është domosdoshmëri, pohojnë autorët në parathënie.*

Doracaku që ndodhet para lexuesve është pikërisht në funksion të “*ballafaqimi*” me periudhën më traumatike të historisë sonë moderne dhe detyrimit të çdo profesori të historisë për të hapur një diskutim mbi këto tema, dhe për të mos ikur nga ato, nën pretendimin e gabuar se janë tema kontroverse. Në historiografi, si dhe në sistemin arsimor, nuk ka tema pak a shumë kontroverse. Ka vetëm tema të eksploruara dhe të paeksploruara. Krimet e luftës të viteve ‘90 janë pa dyshim shembuj historiografikë të hulumtuar mirë dhe nuk egziston asnjë justifikim për shmangien e këtyre temave në orët e historisë. Përkundrazi, me diskutim racional dhe të bazuar metodologjikisht mund të çojë në shembjen e stereotipeve të vendosura tek të rinjtë dhe njohja e tyre për këto pjesë të së kaluarës malazeze mund të jetë vetëm në dobinë e tyre.

Vlera shtesë e këtij doracaku është shpjegimi dhe prezantimi i detajuar i kontekstit historik të luftërave në ish-Jugosllavi, si dhe prezantimi i këtyre temave në tekstet zyrtare të historisë së Malit të Zi. Me një analizë gjithëpërfshirëse në këto dy kapituj, autorët u ofrojnë lexuesve, përkatësisht mësuesve, për të cilët ky doracak është bërë, një bazë të qartë metodologjike dhe kontekst historik në të cilin ata shtjellojnë të gjithë temën. Megjithatë, fokusi është në krimet e luftës që ndodhën në territorin e Malit të Zi gjatë viteve të 90-ta. Përveç rishikimit kronologjik individual të çdo krimi, doracaku përmban edhe fragmente nga vendimet gjyqësore, pjesë të materialit dëshmues dhe burime të ngjashme që ofrojnë një pasqyrë më të gjerë të të gjithë ngjarjes. Në atë pjesë duhet vënë në dukje problematizimi i një procesi shumë të rëndësishëm, që është qëndrimi i shoqërisë malazeze ndaj shfaqjes së të ashtuquajturit “*luftëtar i fundjavës*”. Autorët e përdorin këtë term për të shpjeguar individë nga Mali i Zi, të cilët vullnetarisht, në fillim të viteve ‘90, kanë shkuar në zonat kufitare të konfliktit, ku kanë marrë pjesë në grabitje, përndjekje dhe vrasje të civilëve. Qëndrimi i shtetit malazez ndaj të ashtuquajturve “*luftëtarëve të fundjavës*” do të jenë treguesi kryesor i gatishmërisë së organeve gjyqësore malazeze për t’u përballur me krimet e luftës, sepse numri i këtyre individëve nuk është i vogël dhe një numër i konsiderueshëm i tyre, në periudhën e mëvonshme kanë mbajtur funksione dhe poste publike, veçanërisht në sistemin e sigurisë së Malit të Zi.

Në fund, korniza metodologjike e doracakut përmbillet me një kapitull të veçantë me rekomandime për mësuesit, në të cilin tregohet rëndësia e vendimeve gjyqësore dhe provave në proceset gjyqësore. Në atë pjesë, autorët nuk kufizohen vetëm në vendimet e gjykatave nga Mali i Zi dhe shembujt specifikë të përfshirë në doracak, por gjithashtu u referohen arkivave të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Në këtë kontekst, sugjerojnë aplikimin e metodës që mbështetet në një qasje që thekson atë që është interesante dhe e rëndësishme për nxënësit, dhe profesorët kanë lirinë të përcaktojnë aspektet më të rëndësishme që duan t’u përcjellin nxënësve. Përdorimi i kësaj metode i lejon stafit mësimdhënës të përqendrojë mësimdhënien në tema kyçe, gjë që ndihmon më tej gjeneratat e reja të kuptojnë më mirë kompleksitetin dhe rëndësinë e ngjarjeve historike, duke kontribuar kështu në një kuptim më të thellë dhe ndërtimin e paqes së qëndrueshme.

Me të dhëna empirike dhe bazë të gjerë burimesh dhe literaturë, autorët e doracakut në mënyrë të qartë metodologjike rrëzojnë paragjykimet e vërtetuara dhe shpesh të pasakta për temat “*kontroverse*” të viteve ‘90, duke treguar se nga këto tema nuk duhet fshehur, por përkundrazi, mënyra më e mirë është të përballësh drejtpërdrejt me ta. Doracaku “*Krimet e luftës të viteve 1990 në vendimet e gjyqësorit malazez*” padyshim paraqet një material të shkëlqyer mësimor në shkollat malazeze dhe kam kënaqësinë t’ia rekomandoj botimin e doracakut Qendrës për Arsimim Qytetar (QAQ).

*Doc. dr Adnan Prekiq*



